



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA

ZYRA E KRYEMINISTRIT / URED PREMIJERA / OFFICE OF THE PRIME MINISTER

Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës

2008 - 2011

Prishtinë, Prill 2008

1. Hyrja	4
2. Objektivat Kryesore të Qeverisë së Kosovës	5
3. Politikat Prioritare të Qeverisë.....	6
3.1 Rritja ekonomike.....	7
3.1.1 Energjia dhe minierat.....	9
3.1.1.1 Një zgjidhje për krizën energjetike ne Kosove	9
3.1.1.2 Sektori minerar.....	15
3.1.2 Transporti dhe Telekomunikacioni.....	17
3.1.2.1 Infrastruktura rrugore.....	17
3.1.2.2 Hekurudhat.....	18
3.1.2.3 Aviacioni.....	18
3.1.2.4 Telekomunikacioni	19
3.1.3 Arsimi.....	20
3.1.4 Sundimi i ligjit dhe rendi	24
3.1.5 Bujqësia dhe zhvillimi rural.....	28
3.1.6 Politika tatimore dhe administrimi.....	30
3.1.7 Sektori financiar.....	31
3.2 Implementimi i statusit.....	32
3.2.1 Decentralizimi.....	33
3.2.2 Krijimi i një ambientit të sigurt në Kosovë.....	34
3.2.3 Integrimi i Komuniteteve dhe Kthimi i të Zhvendosurve.....	34
3.2.4 Politika e jashtme e Republikës së Kosovës	35
3.3 Qeverisja e mirë	37
3.3.1 Reforma në Administratën Publike.....	38
3.3.2 Menaxhimi i Financave Publike	39
3.3.3 Luftimi i korrupsionit	40
3.3.4 Përmirësimi i ekzekutimit të shpenzimeve kapitale.....	41
3.4 Zbutja e varfërisë dhe Stabiliteti social	43
3.4.1 Pensionet dhe transferet tjera sociale.....	43
3.4.2 Shëndetësia	45

4. Politikat tjera Qeveritare	48
4.1 Zhvillimi i Sektorit Privat	48
4.2 Vetëqeverisja Lokale	50
4.3 Mjedisi dhe Planifikimi Hapësinor	51
4.4 Bashkëpunimi me donatorët	52
4.5 Barazia Gjinore	52
4.6 Kultura, Rinia dhe Sporti	53
4.7 Regjistrimi i popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave.....	55
4.6 Diaspora	56

1. Hyrja

Programi qeveritar paraqet bazat për një Kosovë shtet të qytetarëve, të zhvilluar në përputhje me parimet demokratike, të një ekonomie të qëndrueshme, mjedisi shumetnik, e përkushtuar qartë në drejtim të proceseve për Integritim Evropian dhe Euro-Atlantike, nëpërmjet të përmbushjes së kushteve dhe standardeve më të larta të përgjegjësisë dhe të transparencës.

Vullneti, synimi dhe destinacioni përfundimtar i Kosovës, pa asnjë dyshim është Bashkimi Evropian. Synimi që Kosova të jetë pjesë e BE-së buron nga konsensusi i gjerë publik dhe kërkon angazhim serioz të institucioneve Qeveritare, në kuadër të procesit formal të para-anëtarësimit dhe për sigurimin e statusit të vendit kandidat.

Qeveria do të zbatojë politika që Kosovës do t'i sigurojë paqe të përhershme, stabilitet, siguri dhe bashkëpunim me shtetet e rajonit e më gjerë. Populli i Kosovës ka gatishmëri që të punojë drejt arritjes së këtij synimi dhe qeveria e Kosovës do të bëjë hapa serioz dhe domethënës drejt arritjes së këtij objekti.

Pas shpalljes dhe njohjes së pavarësisë, ndërtimi dhe funksionalizimi i institucioneve të shtetit është prioritet i fokusuar i Qeverisë së Kosovës. Ky program është i fokusuar në artikulimim e kërkesave imediate të kësaj faze.

Qeveria e Republikës së Kosovës, e vetëdijshme për këtë gjendje, dhe e bindur se Kosova po kalon nëpër fazën e transformimeve dhe tranzicionit ekonomik drejt ekonomisë së tregut, do të punojë me tërë kapacitetet e saja me qëllim të arritjes së synimit të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe mirëqenies qytetare.

Qeveria e Republikës së Kosovës është e përcaktuar në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, që të angazhohet dhe të punojë me përkushtim për realizimin e qëllimeve

strategjike të politikës shtetërore, si dhe sigurimin e një pozite të favorshme të shtetit tonë në rrjedhat e politikës ndërkombëtare.

Qeveria paraqet këtë Program duke qenë e sigurt në mundësitë dhe potencialet e saja për të udhëhequr shtetin, duke menaxhuar me ndryshimet, risqet dhe dobitë, që do të sjellin paqe dhe siguri.

2. Objektivat kryesore të Qeverisë së Kosovës

Kabineti i ri qeveritar dhe ky program vjen si nevojë e krijimit të një klime të re pozitive, moderne dhe menaxhimit të suksesshëm të të gjitha këtyre proceseve. Njëkohësisht, fryma e këtij programi është shprehje e vetëdijes dhe përgjegjësisë së Qeverisë, përballë angazhimeve të cilat janë promovuar dhe votuar në zgjedhjet e fundit më 17 nëntor 2007.

Me aprovimin e Kushtetutës së Republikë së Kosovës, të gjitha proceset zhvillimore politike dhe shoqërore do të jenë të bazuara thellë në parimet dhe dispozitat e Kushtetutës, duke garantuar sovranitetin territorial dhe barazinë para ligjit të të gjithë qytetarëve.

Në kuadër të përkushtimit të Qeverisë për Integrim në BE, Qeveria do të vazhdojë me konsolidimin e institucioneve Qeveritare: kompletimin e legjislacionit, luftimin korrupsionit dhe krimin të organizuar. Qeveria, po ashtu, do të vazhdojë me konsolidimin e administratës publike në funksion të qëndrueshmërisë institucionale, në përputhje me standardet evropiane.

Qeveria e Republikës së Kosovës, e cila doli nga zgjedhjet e qytetarëve, është e vendosur që t'u përgjigjet kërkesave dhe nevojave të qytetarëve të Kosovës dhe të vihet në shërbim të tyre për të udhëhequr një politikë të përgjegjshme, të pjekur dhe transparente, që do ta shpie Kosovën drejt një rritjeje të shpejtë dhe të qëndrueshme ekonomike, nga e cila rritje do të përfitojnë të gjithë qytetarët e saj. Qeveria është e përkushtuar në krijimin e një ambienti të qetë dhe të sigurt për të gjithë qytetarët e saj.

Qeveria është e përkushtuar që sa më parë të përfundojë ndërtimin e mirëbesimit me qytetarët tanë. Vetëm përmes mirëbesimit të ndërsjellë dhe bashkëpunimit të ndershëm dhe korrekt mund të realizojmë drejtësi për të gjithë, arsim më cilësor, investime më të sigurta, që do të rezultojë me një zhvillim më të shpejtë dhe të qëndrueshëm ekonomiko-shoqëror. Kjo do të reflektohet në shoqëri me vende të reja të punës, dhe njëkohësisht përmirësimin e mirëqenies së të gjithë qytetarëve.

Synimet e lartshënuara do të arrihen me një bashkëpunim të ngushtë me të gjithë aktorët politikë dhe shoqëror, duke përfshirë shoqërinë civile, komunitetin e biznesit, institucionet akademike dhe partnerët ndërkombëtarë.

Në funksion të respektimit të vullnetit të qytetarëve, të shprehur nëpërmes votës së lirë, Qeveria do të angazhohet për të realizuar reformat e gjithanshme politiko-shoqërore.

3. Politikat prioritare të Qeverisë

Një Kosovë ekonomikisht e qëndrueshme dhe një shoqëri multi-etnike, në rrugën e saj drejt Integritit Evropian, përmbushja e standardeve më të larta të përgjegjësisë dhe transparencës, është synimi kryesor i Qeverisë sonë. Në këtë drejtim, Qeveria paraqet prioritetet e shprehura në katër shtylla:

- **Rritja ekonomike**
- **Implementimi i statusit**
- **Qeverisja e mirë**
- **Zbutja e varfërisë dhe stabiliteti social**

Këto prioritete kanë dalë nga procesi i konsultimit me komunat dhe me ministrinë e linjës në Qeveri, si dhe me shoqërinë civile. Kostoja e prioriteteve do të përcaktohet në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve, që është në përgatitje e sipër. Synim i Qeverisë është që këto

prioritete të jenë të përballueshme dhe të qëndrueshme në aspektin fiskal. Këto prioritete përbëjnë platformën e punës së kabinetit Qeveritar dhe njëkohësisht do të shërbejnë për Konferencën e Donatorëve për Kosovën. Përcaktimi i politikave prioritare dëshmon përkushtimin e fuqishëm dhe seriozitetin e Qeverisë për të filluar menjëherë me adresimin e çështjeve më prioritare dhe sfiduese për zhvillimin ekonomik dhe social të Kosovës. Më poshtë elaborohen shtyllat prioritare të Qeverisë.

3.1 Rritja ekonomike

Prioritet parësor i Qeverisë së Kosovës do të jetë intensifikimi i zhvillimit ekonomik. Rritja ekonomike do të realizohet përmes intensifikimit të investimeve, privatizimit të mëtejshëm dhe ristrukturimit të ndërmarrjeve publike, shtimit të aftësisë konkurruese të ekonomisë dhe rritjes së eksportit.

Kosova ka një ekonomi të vogël me një nivel jo të kënaqshëm të zhvillimit ekonomik. Në vitet e pasluftës, zhvillimi ekonomik i Kosovës ishte relativisht i ulët, me norma të rritjes ekonomike prej 3-4%. Shkalla e papunësisë vlerësohet të jetë rreth 30 deri në 40%, kurse ajo e varfërisë ekstreme, kap shifrën prej rreth 15%.

Shikuar në përgjithësi, ekonomia e Kosovës është mjaft e varur nga sektori i jashtëm. Niveli i importeve është mjaft i lartë, dhe në trend rritës. Kjo, në njërin anë vjen si pasojë e vetë rritjes ekonomike, kurse në anën tjetër, edhe nga niveli i lartë i parave të dërguara nga diaspora (remitencat), të cilat financojnë deficitin e lartë tregtar. Gjithashtu, ekonomia e Kosovës karakterizohet nga një prezencë e lartë e donatorëve të jashtëm, por në vitet e fundit, tërheqja graduale e tyre ka ngadalësuar rritjen ekonomike.

Kosova karakterizohet me një infrastrukturë të dobët, dhe njëkohësisht me një produktivitet të ulët. Kapacitetet ekzistuese energjetike dhe infrastruktura e dobët rrugore identifikohen si barriera kryesore për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik. Vështirësi, megjithatë, nuk paraqiten vetëm me kapitalin fizik, por edhe në fusha të tjera, si sundimi i ligjit dhe sektori financiar ende në zhvillim.

Potenciali i resurseve natyrore të Kosova paraqet bazë të mirë për zhvillim në të ardhmen. Pasuritë minerale, energjetike, toka bujqësore dhe potencialet turistike, që janë mjaft të bollshme në Kosovë, nuk janë duke u shfrytëzuar sa duhet.

Në tregun e punës, përkundër popullsisë mjaft të re, ekonomia e Kosovës ka një deficit të fuqisë punëtore në lëmi të caktuara dhe norma të larta të papunësisë tek të rinjtë.

Duke pasur parasysh qëllimin kryesor për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, në plan afatmesëm Qeveria e Kosovës do të aplikojë politika që do të ndikojnë direkt në: rritjen ekonomike, uljen e shkallës së papunësisë, përmirësimin e kushteve sociale dhe zvogëlimin e varfërisë.

Në mënyrë që të arrijë këtë, Qeveria e Kosovës do të punojë në krijimin e një ambienti të përshtatshëm për tërheqjen e investimeve të huaja direkte (IDH). Në mënyrë që të jetë konkurruese me vendet e regjionit, Kosova duhet t'i nënshtrohet të ashtuquajturit "proces i përshtatjes", ku synohet që produktet vendore të bëhen më të lira se sa ato të regjionit, me qëllim të stimulimit të eksportit dhe zëvendësim të importit. Kosova nuk ka politikë të pavarur monetare, dhe, duke përdorë euron, ajo nuk mund të bëjë zhvleftësimin nominal të monedhës së saj. Për këtë arsye shkalla konkurruese mund të arrihet vetëm përmes zvogëlimit të kostos së operimit të ekonomisë vendore. Kjo nënkupton rritjen e produktivitetit.

Rritja e produktivitetit arrihet përmes investimeve kualitative. Në veçanti, do të investohet në sektorin e energjisë, në mënyrë që të ketë furnizim të pandërprerë me energji dhe në infrastrukturën tjetër fizike, posaçërisht atë rrugore dhe hekurudhore, që do të mundësonin lidhjen e Kosovës me vendet fqinje. Qeveria do të angazhohet për ngritjen e cilësisë së arsimit, për t'iu përshtatur nevojave të tregut. Për të krijuar kushte tërheqëse për investime, vëmendje e veçantë do t'i kushtohet fushës së sundimit të ligjit, tregut financiar dhe politikave fiskale.

Sektori i bujqësisë është gjithashtu i rëndësishëm, sepse revitalizimi i këtij sektori, do të ndikojë direkt në uljen e papunësisë dhe zbutjen e varfërisë. Prandaj një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet edhe këtij sektori.

Është e qartë, duhet të ndërmerren shumë reforma dhe përshtatje të politikave, që Kosova të arrijë dhe të mbajë nivelet e rritjes ekonomike tipike për rajonin. Duhet të bëjmë eliminimin e shtrëngesave për rritjen ekonomike, që janë identifikuar shumë herë nga ekspertë vendorë e ndërkombëtarë. Prandaj, me qëllim të krijimit të kushteve për rritje ekonomike, Qeveria e Kosovës do të koncentrohet në këto fusha:

- Energjia dhe minierat
- Transporti
- Sundimi i ligjit
- Edukimi
- Bujqësia
- Politikat tatimore dhe administrimi
- Sektori financiar

3.1.1 Energjia dhe minierat

3.1.1.1 Një zgjidhje për krizën energjetike ne Kosove

Furnizimi cilësor dhe i qëndrueshëm me energji paraqet parakusht të zhvillimit të gjithmbarshëm të zhvillimit ekonomik të Kosovës. Një politikë e shëndoshë energjetike mbështet mjedisin biznesor dhe tërheqjen e investimeve, dhe si rrjedhim, zhvillimin ekonomik dhe shoqëror.

Synimet kryesore të Qeverisë në këtë sektor janë:

- Sigurimi i besueshmërisë së kapaciteteve gjeneruese të energjisë elektrike me synim furnizimin e qëndrueshëm me energji elektrike,

- Vazhdimi i reformimit dhe ristrukturimit për ta bërë sektorin energjetik të qëndrueshëm financiarisht dhe atraktiv për investime,
- Modernizimi i rrjetit të bartjes dhe shpërndarjes, duke siguruar integrimin e tyre në rrjetin rajonal dhe evropian të energjisë deri në vitin 2011,
- Rritja e eficiencës së energjisë dhe shfrytëzimi i burimeve të ripërtëritshme,
- Sanimi i pasojave mjedisore të krijuara nga termocentralet ekzistuese si dhe zbatimi i përpiktë i normave ndërkombëtare për mbrojtjen e mjedisit lidhur e objekteve të reja energjetike.

Kosova ende ndeshet me shkurtimet e energjisë elektrike. Është e qartë që furnizimi i pasigurt me energji është pengesa kryesore për zhvillimin e bizneseve private.

Qeveria parashikon që zhvillimi i ardhshëm, i shpejtë dhe i qëndrueshëm i Kosovës, të mbështetet në shfrytëzimin e burimeve natyrore, nëpërmjet nxjerrjes dhe përpunimit, duke ua shtuar atyre vlerën në tregjet ndërkombëtare, duke siguruar kështu njëherësh shtimin e ndjeshëm të punësimit në industrinë nxjerrëse dhe përpunuese të mineraleve.

Qeveria ka përcaktuar sektorin e energjisë si një ndër shtyllat kryesore mbështetëse të zhvillimit ekonomik e social të qëndrueshëm të Kosovës. Kjo nënkupton: (i) domosdoshmërinë e ristrukturimit dhe liberalizimit të sektorit energjetik dhe zhvillimin e tij, përfshirë ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese dhe (ii) nxjerrjen dhe përdorimin racional të linjtit për prodhimin e energjisë elektrike, për të plotësuar nevojat gjithnjë në rritje të vendit për energji elektrike, si dhe për të eksportuar një pjesë të kësaj energjie. Kjo qasje e Qeverisë për zhvillim të sektorit energjetik dhe shfrytëzim racional të linjtit (nëpërmjet teknologjive të avancuara dhe komercialisht të vërtetuara) mbështetet në Strategjinë për Energji të Kosovës për periudhën 2005-2015.

Siguria e furnizimit të qëndrueshëm me energji elektrike në Kosovë përbën një prioritet parësor për periudhën afatshkurtër deri në atë afatmesme. Për të mundur këtë, Qeveria e Kosovës angazhohet të ndërmarrë masat e nevojshme strukturore dhe organizative që, në përputhje me qasjen dhe praktikën më të mira ndërkombëtare, të sanojë sektorin

elektroenergjetik, duke e shndërruar atë në një sektor jo vetëm që siguron furnizim të mjaftueshëm me energji elektrike, por edhe që mbështet fuqishëm zhvillimin ekonomik të vendit.

Qeveria do të vazhdojë reformën e nisur në sektorin energjisë, duke e përgatitur atë për tërheqje të investimeve private, sidomos në ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese. Krijimi i kushteve për një treg pa monopol të energjisë elektrike në Kosovë, në përputhje edhe me detyrimet që rrjedhin nga Traktati për Komunitetin e Energjisë në Evropën Juglindore, përbën qasjen e Qeverisë për tërheqje të investimeve, për të siguruar çmime sa më të favorshme të energjisë për konsumatorët.

Qeveria angazhohet që tarifat e energjisë elektrike të reflektojnë koston aktuale të prodhimit dhe të jenë të përballueshme nga të ardhurat e konsumatorëve familjarë. Ndërkohë, Qeveria do të plotësojë bazën ligjore dhe mbështesë përgatitjen dhe realizimin e një fushate gjithpërfshirëse ndërgjegjësuese për rritjen e faturimit dhe inkasimit të energjisë elektrike nga qytetarët dhe biznesi.

Strategjia është ndarë në qëllimet (objektivat) afatshkurta dhe afatgjate, të cilat janë të ndërlidhura dhe të ndër-varura me njëra-tjetrën. Hapat afatshkurtër do të shërbejnë për stabilizimin e sektorit energjetik dhe do të jenë shërbim të zhvillimit të skenarëve zhvillimorë afatgjata, p.sh. ndërtimi i Termocentralit të ri Kosova C dhe eksporti eventual i energjisë elektrike.

Në afat të shkurtër: Me qëllim të daljes nga kriza energjetike dhe zhvillimi i këtij sektori, parashihet një strategji me tri faza. Padyshim, se involvimi i kapitalit privat në këtë sektor është domosdoshmëri. Andaj, Qeveria do të gjejë format më të përshtatshme për të privatizuar KEK-un përmes një procesi transparent, mirë të menaxhueshëm, që do të sjellë përfitime të shumëfishta Kosovës.

Kosova mund të fillojë me marrëveshje për koncesionim, dhe/ose privatizim, të njësive aktuale të prodhimit dhe minierave, para se të bëhet zgjedhja (seleksionimi) i investitorit për

Kosovën C. Ndonëse format me te mira do te vazhdojnë te hulumtohen dhe analizohen, një shembull i grupeve të caktuara të sektorëve të KEK-ut te cilat do te mund te jepeshin ne koncesion ose forma tjera te tërheqjes se investimeve, jepet më poshtë.

1. Njësitë prodhuese A1 dhe A2;
2. Njësitë prodhuese A3, A4 dhe A5;
3. Njësitë prodhuese B1 dhe B2;
4. Miniera Mirash;
5. Miniera Bardh;
6. Miniera Sitnica;
7. Miniera Sibovc.

Mundësitë për koncesionim dhe/ose privatizim mund të përfshinë kombinimin 1, 2, dhe 3 dhe minierave 4, 5, 6 dhe 7. varësisht nga rrjedhshmëria dhe kombinimet më të përshtatshme për përfitim të Kosovës.

Projektet afatshkurtra të privatizimit në sektorin e energjetikës do t'i ofrojnë Kosovës përfitime të shumta direkte financiare dhe indirekte ekonomike, ndër to:

- Kursim të subvencioneve buxhetore 50-70 milion euro në vit;
- Te hyrat shtese nga koncensionimi dhe privatizimi;
- Te hyra te vazhdueshme nga koncensionimi;
- Te hyra nga taksat dhe tatimet; si dhe
- Punësime dhe paga te vazhdueshme.

Në afat të gjatë: Procesi i ndërtimit të Termocentralit Kosova C do të është synim i Qeverisë për zgjidhjen e çështjes së furnizimit me energji elektrike të Kosovës. Projekti do të përcjellë dinamikën kohore të vendosur me asistencë teknike nga Banka Botërore, AER dhe USAID. Procesi i Kosovës C duhet të përcillet me forma me te avancuara te tenderimit transparent dhe konkurrues, ndërsa madhësia maksimale, fazat e zhvillimit, lokacioni, dhe teknologjia e termocentralit duhet të bazohet në studimin e kujdesshëm të implikimeve sociale dhe

ambientale. Kontrata do të përfaqësojë interesin komercial të Kosovës në mënyrën më të mirë të mundshme.

Me qëllim të realizimit të suksesshëm të këtyre hapave, Qeveria e Kosovës do të krijojë një ambient të sigurt dhe atraktiv për pjesëmarrje të investitorëve privat në sektorin e energjetikës, duke paraqitur interesin komercial të Kosovës dhe do të krijojë një operim efikas me sektorin. Qeveria e Kosovës gjithashtu do të punojë në mënyrë agresive në zvogëlimin e humbjeve komerciale (vjedhjeve të energjisë elektrike) duke angazhuar edhe kapacitetet e policisë dhe gjyqësisë në shërbim të përpjekjeve të Distribucionit në rritjen e faturimit dhe pagesës.

Energji alternative: Përveç formave të prodhimit të energjisë elektrike me bazë linjtin, do të hulumtohen potenciale tjera të përfitimit të energjisë. Të tilla hidrocentrale si në Zhur dhe projekte tjera për hidrocentrale të vogla mund të ndërtohen, pas rishqyrtimit që të shpërndahen burimet e energjisë kah energjitë ripërtëritëse dhe për të siguruar zhvillim të qëndrueshëm të sektorit. Duke patur parasysh rishqyrtimin e studimit për para-fizibilitet për Zhur, dhe zhvillimin e metodologjisë për ‘feedinf-tariff’ nga ZRRE. Këta dy projekte mund të realizohen krahas projekteve të paraqitura më lartë. Poashtu, do të hulumtohen mundësitë për projektet me energji të erës, gjeotermale, diellore dhe burime tjera alternative të energjisë elektrike.

Përfundime/Përfitimet

1. implementimi i kësaj strategjie do të ju ndihmojë qytetarëve dhe bizneseve të Kosovës për të patur furnizim të vazhdueshëm me energji elektrike Brenda 9-15 muaj.
2. kjo më lartë do të rezultojë në një rrjet të privatizuar të distribucionit, prodhim vendor i energjisë elektrike më i mirë, dhe një praktikë e vendosur e partneritetit privat-publik në sektorin e energjetikës.

3. Kompanitë do të udhëheqin prodhimin dhe distribucionin si biznese efikase me motiv profiti duke përfituar populli i Kosovës.
4. Strategjia do të ndihmojë, për herë të parë, të kthejë rrjedhën e fondeve nga buxheti në sektorin energjetik, ashtu që paratë do të rrjedhin në drejtim të kundërt- nga sektori energjetik në buxhetin e Kosovës.
5. Furnizimi i vazhdueshëm me energji elektrike do të ndihmojë zhvillimin e sektorit privat duke patur ndikim pozitiv në zvogëlimin e papunësisë dhe ngritjen e mirëqenies.
6. aktivitetet afatshkurtra që përfshinë privatizimin dhe koncensionimin në sektorin e energjetikës do të ndikojnë në përmirësimin e klimës investuese për Kosovën C.
7. Pjesëmarrja e kapitalit privat dhe ekspertiza e gjeneratës ekzistuese në Kosovë si dhe operacionet në miniera gjithashtu do të ndihmojnë në avancimin e performancave ambientale, zvogëlojnë detyrimet sociale dhe ambientale, dhe do të sigurojnë një dislokim të lehtë të pajimeve ndotëse.
8. Qeveria do të kërkojë energji alternative nga uji, era dhe dielli, që të diversifikojë burimet e energjisë për një zhvillim më të qëndrueshëm të sektorit.
9. qeveria e Kosovës do të jetë e aftë të përkushtohet në zhvillimin e rrjetit transmetues (përçues) sipas obligimeve që dalin nga Marrëveshja e Athinës për energji.
10. Zvogëlimi i rrezikut në sektorin e energjetikës do të krijojë kushte atraktive për investimet e huaja dhe të vendit në të gjithë sektorët, dhe do të ndihmojë fuqimisht në zhvillimin ekonomik të përgjithshëm dhe vizionin zhvillimor të Kosovës.

3.1.1.2 Sektori minerar

Kosova është e pasur me resurse minerale energjetike, metalike dhe jo-metalike. Shfrytëzimi i linjitit, xeheve të plumb zinkut dhe mineraleve të tjera në Kosovë ka traditë të gjatë dhe gjithmonë ka pasur rol të rëndësishëm social dhe ekonomik. Synimi kryesor i strategjisë minerare është maksimalizimi i “rentës ekonomike” nga shfrytëzimi i pasurive minerare.

Synimet kryesore të sektorit minerar janë:

- Sistemi Ligjor, që mundëson qeverisje efikase dhe transparente,
- Krijimi i një ambienti të përshtatshëm dhe tërheqës për investime, dhe
- planifikimi dhe zhvillimi i sektorit minerar në pajtim me standardet evropiane mjedisore dhe sociale.

Së shpejti do të përfundojë përgatitja dhe miratimi i Strategjisë së Kosovës për sektorin e minierave. Qëllimet kryesore të kësaj strategjie janë: (i) të vlerësojë ekonomikisht burimet minerale dhe të linjitit në Kosovë, dhe kontributin maksimal që ato mund dhe duhet të japin në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik e social të Kosovës, nëpërmjet rentës ekonomike (të ardhurat që do të sigurohen për Kosovën nga dhënia e të drejtave për shfrytëzimin e burimeve natyrore të Kosovës) për dhënien e të drejtës së shfrytëzimit të tyre, (ii) të propozojë masat, format dhe hapat e përshtatshme për transformimin e sektorit të minierave, duke e përgatitur dhe bërë atë atraktiv për investime private, kryesisht në formën e partneritetit publik-privat, dhe (iii) të paraqesë planin konkret afatmesëm dhe afatgjatë për zhvillimin e këtij sektori.

Ristrukturimi i sektorit të minierave dhe ndërmarrjeve të tij do të ketë për qëllim rehabilitimin dhe modernizimin e aseteve ekzistuese për të siguruar shtimin e prodhimit dhe përpunimit në vend të burimeve minerare. Investime të mëdha do të kërkohen për arritjen e këtij qëllimi. Këto investime do të synohet të mobilizohen nga sektori privat. Për këtë kërkohet që sektori minerar të ristrukturohet në atë mënyrë që të mundëson tërheqjen e këtyre investimeve shumë të nevojshme.

Parimet mbi të cilat do të mbështeten partneritetet publike-private në Kosovë do të përfshijnë (i) vlerësimin / rivlerësimin e burimeve natyrore ekonomikisht të shfrytëzueshme. Për këtë Qeveria do të përgatisë një metodologji të përshtatshme për vlerësimin e këtyre burimeve, (ii) shfrytëzimin e burimeve natyrore në atë mënyre që të sigurohen të ardhura financiare dhe ekonomike maksimale të mundshme, dhe (iii) shfrytëzimin në mënyrë racionale të burimeve, duke mbrojtur maksimalisht mjedisin. Për këtë të fundit do të kërkohet respektimi i normave të lejuara Evropiane për ndotjen e mjedisit nëpërmjet përdorimit të teknologjive të avancuara dhe komercialisht të vërtetuara, dhe rikultivimi i mjedisit në kushtet fillestare, pas shfrytëzimit të burimit natyror.

Investimet private në sektorin e minierave do të tërhiqen nëpërmjet proceseve të konkurrencës së hapur, transparencës dhe jo-diskriminimit. Qëllimi i Qeverisë së Kosovës është që të sigurojë investime dhe të ardhura maksimale të mundshme nga shfrytëzimi i burimeve natyrore. Qeveria do të synojë që rreziqet / përfitimet që lidhen me luhatjet në tregjet ndërkombëtare, të ndahen midis saj dhe investitorëve privatë, me të cilët ajo do të krijojë partneritet për shfrytëzim të burimeve natyrore. Ndërkohë, Qeveria do të angazhohet për rinegociimin e çdo kontrate të lidhur me herët, e që rezulton e dëmshme për Kosovën.

Për mundësimin e zbatimit të politikave të paraqitura më sipër, Qeveria do të përgatisë ligjin për koncesione. Qeveria do të shqyrtojë edhe mundësinë e rregullimit më të përshtatshëm institucional për arritjen dhe ndjekjen e marrëveshjeve të koncesioneve dhe partneriteteve publike - private.

Qeveria do të synojë lidhjen e çmimit të burimit natyror apo produktit të nxjerrë prej tij me çmimet në tregjet përkatëse ndërkombëtare, sa herë që kjo është e mundur.

Zhvillimi institucional dhe ai i kapaciteteve njerëzore për sektorët e energjisë dhe minierave do të jete një nga objektivat e Qeverisë për të siguruar një menaxhim adekuat të këtyre sektorëve në të ardhmen.

Qeveria e Kosovës do të ndajë një pjesë prej të ardhurave nga shfrytëzimi i burimeve natyrore për komunitetin lokal, ku ndodhet e shfrytëzohet burimi natyror. Këto të ardhura do të përdoren për zhvillim e punësim në nivel komunal, duke siguruar kështu një pranim dhe mbështetje nga komuniteti të partneritetit publik-privat përkatës.

3.1.3 Transporti dhe Telekomunikacioni

3.1.2.1 Infrastruktura rrugore

Duke ditur gjendjen e vështirë në infrastrukturën rrugore dhe hekurudhore, si dhe duke pasur parasysh rëndësinë e shërbimeve në sferën e telekomunikacionit, Qeveria e Kosovës synon t'i ngrisë ato në përputhje me standardet evropiane, që do të jenë bartëse të zhvillimit ekonomik. Një infrastrukturë e zhvilluar do të ndihmojë Kosovën të jetë pjesë e integriteteve regjionale dhe evropiane.

Me qëllim të krijimit të kësaj infrastrukture, si dhe të ndërlidhjes dhe të ndëroperacionalizimit të rrjeteve kombëtare me ato regjionale dhe transevropiane, në harmoni me politikat e zhvillimit të transportit multimodal, duhet bërë investime me interes kombëtar, gjeopolitik dhe gjeostrategjik,

Këto investime duhet orientuar në këto pika:

- Ndërtimi i Autorrugëve R6 dhe R7,
- Ndërtimi i rrugëve të reja,
- Zgjerimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e rrugëve ekzistuese,
- Bashkëfinancimet me komuna,
- Rikategorizimi i rrugëve,
- Rregullimi i kadastrit të rrugëve,
- Rritja e sigurisë në komunikacion.

3.1.2.2 Hekurudhat

Hekurudha ka përparësitë e veta në aspektin ekonomik, energjetik, ekologjik dhe atë të sigurisë. Përveç kësaj, hekurudhat mundësojnë transport të lehtë, të lirë, të shpejtë dhe masiv të njerëzve dhe të mallrave. Sistemi i transportit hekurudhor të Republikës së Kosovës, për të qenë funksional dhe për t'u lidhur me rrjetet themelore evropiane, duhet që brenda kësaj periudhe të orientohet në realizimin e këtyre qëllimeve:

- Krijimi i legjislacionit të nevojshëm dhe trupave rregullative për hekurudhat,
- Investimet në përmirësimin dhe rivitalizimin e infrastrukturës hekurudhore dhe ndërtimin e infrastrukturës së re,
- Investimet në zhvillimin e shërbimeve të transportit hekurudhor,
- Shtimi i sigurisë në komunikacionin hekurudhor.

3.1.2.3 Aviacioni

Për zhvillimin cilësor të transportit ajror, si dhe për sigurimin e kushteve të domosdoshme për zhvillimin e përgjithshëm të aviacionit kosovar, angazhohemi të realizojmë këto qëllime:

- Implementimi i Ligjit për Aviacionin Civil,
- Investimet në zgjerimin, modernizimin dhe zhvillimin e mëtutjeshëm të Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës,
- Rritja e efikasitetit të operacioneve ajrore dhe navigacionit ajror,
- Aftësimi i Aeroportit të Gjakovës për qëllime komerciale dhe si aeroport alternativ për Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës,
- Krijimi i njësisë së Helikopterëve.

3.1.2.4 Telekomunikacioni

Telekomunikacioni është komponent kyç për aktivitetet kombëtare të ekonomisë dhe jetik për krijimin e relacioneve ndërkombëtare komerciale. Industria e telekomunikacionit përbën njërin nga sektorët më dobiprurës për treguesit makroekonomikë, si dhe shërben si katalizator i të ashtuquajturës “ekonomi e dijes”. Në të njëjtën kohë kjo industri shërben edhe si “dritare” për bizneset dhe individët, duke u mundësuar qasje të shpejtë dhe globale. Gjithashtu, ajo është mjet për promovimin e transparencës dhe efijencës së qeverisë.

Synimet e mëposhtme formojnë bërthamën e strategjisë për këtë periudhë, si dhe mundësojnë themelin e zhvillimit afatgjatë të këtij sektori:

- Reformimi i legjislacionit në fushën e telekomunikacionit,
- Marrja e kodit shtetëror për shërbime telefonike dhe e domenit nacional për shërbime të internetit,
- Konsolidimi i operatorit publik të telefonisë,
- Vendosja e rregullit në menaxhimin e spektrit frekuencor dhe të enumeracionit,
- Rritja, zgjerimi dhe përmirësimi shërbimeve telefonike, postare dhe të internetit,
- Realizimi i shërbimeve universale.

Për realizimin e të gjitha këtyre synimeve, Qeveria do të angazhohet:

- Zgjidhjen e statusit të ndërmarrjeve publike, në harmoni me strategjinë legislative të Republikës së Kosovës,
- Gjetja dhe shfrytëzimi i formave të veçanta ose të kombinuara të financimit publik dhe privat,
- Harmonizimi i legjislacionit me standardet e BE-së,
- Bashkëpunimi me organizmat ndërkombëtarë dhe anëtarësimi në organizatat relevante ndërkombëtare, dhe
- Arritja e marrëveshjeve bilaterale dhe multilaterale me shtetet fqinje dhe ato evropiane në fushat përkatëse të Transportit dhe të Telekomunikacionit.

3.1.3 Arsimi

Arsimim, si pjesë e rëndësishme për çfardo strategjie zhvillimore, është edhe investimi afatgjatë në kapitalin njerëzor. Kapitali njerëzor është shumë komplementar me kapitalin fizik dhe ngritja e nivelit të tij tërheq më shumë kapital fizik. Përvoja ndërkombëtare ka treguar se ofrimi i arsimit cilësor ka rëndësi kritike për rritjen e produktivitetit në mbështetje të rritjes dhe zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik. Në bazë të Deklaratës së prioriteteve të Qeverisë, Arsimi është një nga fushat me prioritet të Qeverisë së Kosovës.

Programi i Qeverisë për arsim, që do të jetësohet gjatë mandatit të Qeverisë, përmban këto synime strategjike dhe masa programore:

- Që sistemi arsimor t'i shërbejë një shoqërie të bazuar në dije, ekonomi dhe punësim,
- Arsimi të jetë punë dhe fokus i përbashkët ndërsektorial i tërë Qeverisë së Kosovës,
- Të bëjë sigurimin gjithëpërfshirës, të barazisë dhe respektit të diversiteteve në arsim,
- Të ngrisë qeverisjen, udhëheqjen dhe menaxhimin cilësor dhe efikas në sistemin e arsimit,
- Të ndërtojë lidhje të qëndrueshme të arsimit me zhvillimet ekonomike dhe shoqërore,
- Të avancojë gjendjen materiale të arsimit, përmes zëvendësimit të sistemit aktual linear të pagave të mësimdhënësive, me sistemin e dallimeve pozitive në pagë, në përputhje me kriteret e licencimit,
- Të hartojë politika dhe të krijojë mekanizma për ngritjen e kontrollit dhe të cilësisë në arsimin parauniversitar dhe universitar, si dhe të ngrit kapacitetet për punë kërkimore dhe shkencore.

Për jetësimin e Programit të Qeverisë për Arsim, Shkencë dhe Teknologji, plani zbatues i Qeverisë ndërthet në vete këto masa:

1. Krijimi i një sistemi të përbashkët të arsimit dhe të aftësimeve: Për Qeverinë e Kosovës fusha e arsimit dhe aftësimeve nuk janë të ndara nga njëra tjetra dhe Ministrinë gjegjëse janë të koordinuara në mes veti në definimin e arsimit si prioritet vendimtar për zhvillim ekonomik. Meqë vetëm rritja ekonomike mund të krijojë punësim dhe mirëqenie, edukimi do

të jetë fokus i përbashkët ndër-sektorial i tërë Qeverisë së Kosovës. Prandaj, të gjitha ministritë bashkëpunojnë dhe veprojnë ngushtë në mes vete në fushën e arsimit dhe të aftësimeve profesionale, në hartimin e vijave programore, ndarjen e buxhetit dhe implementimin e tyre. Qëllimi kryesor është shndërrimi i Kosovës në një shoqëri të dijes, e integruar në rrjedhat evropiane, me mundësi të barabarta për zhvillim personal të të gjithë qytetarëve, të cilët i kontribuojnë zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe shoqëror. Qeveria e Kosovës me Programin e saj synon qasje dhe politika arsimore që mundësojnë kalimin prej financimit në investime afatgjate në arsim. Prandaj buxheti i ndarë nga Qeveria e Kosovës për investimet në arsim nuk ka qenë asnjëherë më i madh se që është për këtë mandat qeverisës.

2. Një arsim fillor dhe të mesëm për të gjithë qytetarët: Programi i Qeverisë parasheh përfshirjen e gjithë moshës së re në procesin arsimor dhe përfundimin e nivelit fillor dhe të mesëm. Për këtë prioritet Qeveria synon të arrijë udhëheqje dhe menaxhim efikas në sistemin e arsimit, cilësi në të nxëniet që bazohet në standarde të krahasueshme me vendet e zhvilluara, përgatitje dhe zhvillim profesional të mësimdhënësve, mjedis të përshtatshëm për mësimdhënie dhe mësimnxënie, dhe lidhje të qëndrueshme të arsimit me zhvillimet globale ekonomike dhe shoqërore. Realizimi i Programit të Qeverisë në nivel parashkollor, fillor dhe të mesëm synon:

- Të themelojë dhjetë institucione dhe mekanizma të rinj dhe cilësorë për jetësimin e shërbimeve efikase arsimore,
- Të ngrisë arritshmërinë e nxënësve, që shprehet përmes testeve kombëtare dhe ndërkombëtare për vlerësimin e tyre dhe të institucioneve arsimore,
- Të rishikojë planprogramet dhe tekstet në të gjitha nivelet arsimore me qëllim që sistemi jonë arsimor të jetë i matshëm dhe i krahasueshëm me të gjitha vendet e rajonit dhe ato evropiane,
- Deri në fund të mandatit qeverisës, të ndërtojë mbi 300,000 m² të hapësirës shkollore, me qëllim që të gjithë nxënësit të mësojnë vetëm në dy ndërrime, Të rinovojë rreth 150,000 m² të hapësirës shkollore, për të siguruar kushte cilësore për mësimdhënie dhe mësimnxënie kualitative,

- Të pajisë me kompjuterë dhe qasje cilësore në internet të gjitha shkollat në Kosovës me fokus të veçantë shkollat e mesme,
- Të aftësojë mbi 27,000 mësime dhënë, përmes programeve të mirëfillta trajnuese,
- Të reformojë sistemin e pagave dhe të gradimeve në arsim në bazë të meritës, përvojës dhe përgatitjes profesionale të secilit mësime dhënë,
- Të sigurojë kabinete dhe laboratorë për shkollat e mesme të përgjithshme dhe ato profesionale,
- Ta ndalojë braktisjen nga shkolla dhe të ndërmarrë të gjitha masat për mbështetje për nxënësit me nevoja të veçanta.

3. Sigurimi i cilësisë në arsimin e lartë (mësimdhënie, studim, diskurs akademik) dhe shndërrim i universiteteve në institucione të larta të hulumtimeve shkencore: Programi i Qeverisë së Kosovës për politika dhe mbështetje financiare synon që t'i mbështet të gjithë bartësit e arsimit të lartë në Kosovë në rrugën e vazhdimin të reformave në përputhje me Procesin e Bolonjës - veçanërisht Universitetin e Prishtinës, si institucion vendimtar i arsimit të lartë.

Qëllimi i Qeverisë është zhvillimi i një sistemi efikas të arsimit të lartë që ndikon direkt në ngritjen e mirëqenies së shoqërisë sonë dhe të zhvillimit ekonomik duke ofruar një arsimim dhe kërkim shkencor të cilësisë së lartë, me mundësi të barabarta për të gjithë, në pajtim me vlerat e demokracisë dhe të diversitetit. Realizimi i Programit të Qeverisë në nivelin e arsimit të lartë synon:

- Të ofrojë dhe rishikojë kornizën e nevojshme ligjore për ngritje të kompetencës dhe zbatimin e ligjit në arsimin e lartë,
- Të sigurojë përfshirje më të madhe të gjeneratës së re në arsimin e lartë në harmoni me kërkesat e tregut të punës,
- Të rrisë numrin e institucioneve publike, jofitimprurëse dhe private të arsimit të lartë,
- Të rritet numri i degëve dhe programeve të reja në institucionet e arsimit të lartë,
- Të rritet numri i të punësuarave nga radhët e të diplomuarve në ekonominë e Kosovës,
- Të zvogëlohet kohëzgjatja dhe përfundimi i studimeve të larta,

- Të krijojë struktura për vlerësimin e brendshëm si dhe vlerësimin e jashtëm së bashku me akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë,
- Të rritet mobiliteti i mësimdhënësve dhe i studentëve vendor dhe të huaj,
- Të ngritët infrastruktura institucionale për punë shkencore, inovacion dhe transfer të teknologjisë,
- Të krijohen institute dhe qendra për kërkim shkencor për zgjidhjen e problemeve të shoqërisë dhe në shërbim të ekonomisë,
- Integrimin dhe internacionalizimin e arsimit të lartë në proceset zhvillimore evropiane dhe botërore të arsimit të lartë,
- Të sigurojë donacione më të mëdha për arsimin e lartë,
- Të ofrojë fonde për bursa për studentë, për mësimdhënës si dhe të ulët kostoja e shpenzimeve për studentë,
- Të rrisë hapësirën përdorimin e teknologjisë bashkëkohore dhe pajisjeve laboratorike në studim, mësimdhënie si dhe të rrisë numrin e bibliotekave me literaturë bashkëkohore.

4. Arsimin profesional dhe mësimi gjatë tërë jetës: Për shkak të historisë së gjatë të konfliktit dhe luftës në Kosovë, arsimit ishte në një gjendje pakrahasimisht të vështirë. Për këtë arsye sot Kosova si shtet ka nevojë të veçantë për arsim profesional, programe aftësimi dhe mësimi gjatë tërë jetës. Investimi në këtë formë të arsimit do t'i mundësojë çdokujt, qoftë moshës së re qoftë asaj të thyer të (ri)aftësohet për treg të punës dhe t'i rris mundësitë e ngritjes në karrierë. Një gjë e tillë do të jetë edhe stimulim i drejtpërdrejtë për ngritjen e kualitetit të shërbimeve dhe prodhimit në Kosovë, duke ndikuar drejtpërsëdrejti në ngritjen e përgjithshme të ekonomisë dhe integritit të përshpejtuar të saj në tregun evropian dhe atë global. Për këtë arsye, Qeveria ka për objektivi që diplomat, shkallët dhe gradat e fituara në sistemin e arsimit dhe aftësimeve të Kosovës të orientohen drejt nevojave të tregut dhe sektorëve kyç të ekonomisë. Hartimi i plan-programeve mësimore dhe llojeve të kualifikimeve do të mbështeten në mënyrë të ndërsjellët në mes të institucioneve të arsimit, ekonomisë dhe të industrisë. Edukimi dhe ekonomia do të kooperojnë ngushtë, dhe një pjesë substanciale e investimeve do të ndodhë pikërisht në këto dy sektorë. Gjatë këtij mandati qeverisës do të ndërtohen dhe pajisen shtatë shkolla profesionale të nivelit të mesëm në qendrat kyçe të Kosovës në fushën e teknologjisë së informacionit, të ekonomisë dhe

biznesit, të menaxhmentit dhe tregtisë, të agrikulturës, të shëndetësisë dhe të infermierisë, të profileve teknike dhe të ndërtimtarisë.

3.1.4 Sundimi i ligjit dhe rendi

Në fushën e sundimit të ligjit, synimet kryesore të Qeverisë së Kosovës në fushën e sundimit të ligjit janë:

- Kompletimi dhe harmonizimi i legjislacionit në fushën e sundimit të ligjit,
- Sigurimi i një sistemi gjyqësor dhe prokurorial të pavarur dhe të paanshëm, para të cilit të gjithë qytetarët do të ndihen të sigurt dhe të barabartë,
- Ngritja e kapaciteteve profesionale në Shërbimin Korrektues dhe në Shërbimin Sprovues të Kosovës si dhe përmirësimi i trajtimit të të burgosurve, paraburgosurve në sistemin e burgjeve, konform standardeve dhe rregullave të përcaktuara ndërkombëtare.
- Ofrimi i kushteve më të mira sa i përket mbrojtjes dhe strehimit të viktimave të krimit në përgjithësi, ndërsa atyre të trafikimit në veçanti, si dhe sigurimi i kushteve më të mira për mbrojtjen e dëshmitarëve.
- Qeveria do të angazhohet dhe do të bashkëpunojë ngushtë me institucionet e tjera relevante në luftimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar, që kontribuon drejtpërdrejt në përmirësimin e jetës së qytetarëve dhe të imazhit të Republikës së Kosovës. Kështu do të ndikohet edhe në përshpejtimin e integritetit të Kosovës në integrimet euro-atlantike.

Ministria e Drejtësisë do të angazhohet në themelimin e një Agjencioni të veçantë për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore në rastet që kanë të bëjnë me para, kurse për vendime të tjera përmbarimi të mbetet në kompetencë të gjykatave.

Ministria e Drejtësisë do të angazhohet që të sigurojë kushte të nevojshme edhe për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës, të cilën e konsideron si një institucion mjaft të rëndësishëm në luftimin e krimit dhe forcimin e sundimit të ligjit.

Qeveria e Kosovës do të angazhohet maksimalisht në ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe luftimin e të gjitha dukurive negative në shërbimin korrektues dhe shërbimin sprovues, që të sigurojë kushte edhe më të mira për të burgosurit dhe të paraburgosurit në Republikën e Kosovës.

Qeveria, po ashtu përmes Institutit për Mjekësi Ligjore dhe Zyrës për Persona të Zhdukur do t'i ndërmarr të gjitha masat për kërkimin, gjetjen, ofrimin dhe vërtetimin e informatave lidhur me vendndodhjen e personave të zhdukur.

Qeveria me përkushtim të madh do të angazhohet edhe në periudhën e ardhshme në organizimin e sistemit për ofrimin e ndihmës për të gjitha viktimat e krimit, në veçanti të dhunës familjare, të trafikimit me qenie njerëzore dhe të abuzimit seksual.

Në fushën e rendit, Qeveria e Kosovës do të synojë të krijojë një ambient të sigurt në tërë territorin e Republikës së Kosovës për të gjithë qytetarët pa dallim.

Rëndësi e veçantë do t'i kushtohet kompletimit të infrastrukturës së nevojshme ligjore në përputhje me standardet dhe praktikatat më të mira ndërkombëtare, ndërmarrjen e reformave gjithëpërfshirëse në sektorin e rendit dhe të sigurisë, ngritjes së kapaciteteve humane brenda MPB-së dhe Policisë së Kosovës, intensifikimit të bashkëpunimit me institucionet tjera relevante vendore dhe ndërkombëtare, për të siguruar funksionimin e tërë mekanizmit në fushën e sigurisë.

Më poshtë janë të pasqyruara prioritetet në fushën e rendit:

Ruajtja e Rendit dhe qetësisë publike: Duke marrë për bazë ndjeshmërinë e situatës nëpër të cilën po kalon vendi, duke marrë për bazë situatën e brishtë të sigurisë si dhe duke zbatuar përgjegjësitë që dalin nga mandati, Qeveria ka si prioritet kryesor ruajtjen e rendit dhe qetësisë publike në tërë territorin e Republikës së Kosovës, duke ofruar siguri për të gjithë qytetarët, pa dallim.

Qeveria është e përkushtuar për të shtrirë autoritetin në gjithë territorin e Kosovës, përfshirë edhe ofrimin e sigurisë për funksionimin e institucioneve tjera shtetërore në gjithë vendin.

Qeveria do të angazhohet për: **a)** ruajtjen e institucioneve shtetërore në gjithë vendin, **b)** ruajtjen e infrastrukturës strategjike si : urat, tunelet, hekurudhat, telekomunikacionin, shërbimet e ujit dhe energjisë elektrike në gjithë vendin, **c)** përmirësimin e kontrollit kufitar dhe menaxhimin e kufijve, **d)** reagimin e shpejtë në situata emergjente, **e)** forcimin e mekanizmave për paralajmërim të hershëm, **f)** forcimin e policisë në komunitet, **g)** sigurimin e lirisë së lëvizjes, **h)** mbrojtjen e pronës etj.

Funksionalizimi i sektorit të Sundimit të Ligjit në Kosovë: Objektivi primar në këtë drejtim mbetet funksionalizimi i plotë i Këshillit për Sundimin e Ligjit, si një forum ku mund të gjejmë zgjidhje për sfidat me të cilat ballafaqohemi. Veprimi tjetër konkret është hartimi dhe zbatimi i Ligjit për Organizimin dhe Funksionalizimin e Policisë Gjyqësore.

Lufta kundër Korrupsionit, Krimit të Organizuar dhe Terrorizmit: Luftimi i korrupsionit, krimit të organizuar dhe terrorizmit është lart në agjendën e prioritetëve të Qeverisë. Për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar nevojitet vullnet politik. Është përkushtim i Qeverisë së Republikës së Kosovës që të kemi zero tolerancë ndaj këtyre fenomeneve. Në këtë kontekst kemi paraparë ndërmarrjen e këtyre veprimeve: **a).** Kompletimin e kornizës legjislative **b).** Hartimin e Strategjisë kundër Krimit të Organizuar dhe Terrorizmit, **c).** Hartimin e Strategjisë për Reduktim të Krimit, **d).** Hartimi e planit të veprimit kundër trafikimit të qenieve njerëzore, **e).** Hartimin e Strategjisë dhe Plan-Veprimit për Parandalimin e transportimit ilegal dhe përdorimit të Drogave), **f)** Hartimi i Strategjisë për Grumbullim të Armëve, **g)** Miratimi dhe zbatimi i Ligjit për Armë.

Ngritja e kapaciteteve dhe Funksionalizimi i mëtutjeshëm i Policisë së Kosovës: Zhvillimi dhe ngritja e mëtutjeshme e Policisë së Kosovës, bazuar në Ligjin e miratuar të Policisë, do të bëhet duke investuar në ngritjen e kapaciteteve administrative dhe duke trajnuar/specializuar tutje dhe në vazhdimësi pjesëtarët e Policisë. Poashtu, do të sigurohet bilanci në mes të pavarësisë operuese dhe llogaridhënies brenda Policisë së Kosovës.

Dokumentet Civile: Qeveria synon që gjatë këtij mandati qeverisës të instalojë sistemin e integruar të menaxhimit të dokumenteve civile. Në kuadër të këtij projekti planifikohet që të instalohet një sistem elektronik *online* i regjistrimit civil, i cili është i integruar me Departamentin për Prodhimin e Dokumenteve.

Qeveria angazhohet që menjëherë pas përfundimit të fazës tranzitore të fillojë me prodhimin e dokumenteve personale si: Pasaportave, Dokumenteve të Identifikimit dhe Patentë Shoferëve, gjithnjë në harmoni me standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare. Qeveria do të sigurohet që procesi të jetë transparent, të prodhohen dokumente kualitative dhe me shkallë të lartë të sigurisë, që në një të ardhme jo shumë të largët do të na mundësonin negocimin e Marrëveshjes për lehtësimin e regjimit të vizave me Bashkimin Evropian për t'u pasuar me Marrëveshjen për liberalizimin e tërësishëm të vizave me vendet anëtare të Bashkimit Evropian.

Menaxhimi i situatave emergjente: Qeveria do të përkujdeset në zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera si dhe Ligjin për Mbrojtje nga Zjarri. Në kuadër të planeve të saja për menaxhimin e situatave emergjente, Qeveria ka paraparë këto aktivitete: **a)** finalizimin e planit kombëtar të emergjencave, **b)** evidentimin e resurseve për mbrojtje dhe shpëtim si dhe të objekteve për strehim në nivelin komunal, **c)** evidentimin e lokacioneve që përballen me rrezikshmëri nga vërshimet, ndotjet e ujit të pijshëm dhe rrëshqitjet e dheut, **d)** forcimin e koordinimit ndër-institucional për menaxhimin e situatave emergjente.

3.1.5 Bujqësia dhe zhvillimi rural

Nga sipërfaqja totale e Kosovës prej 1.1 milion ha. 53% mund të kultivohen, ndërsa 41% janë tokë pyjore. Bujqësia është aktiviteti i rëndësishëm ekonomik dhe sektor i cili siguron pjesën më të madhe të punësimit në Kosovën e pasluftës. Bujqësia e Kosovës karakterizohet me ferma të vogla, prodhimtari dhe produktivitet të ulët dhe mungesë të shërbimeve këshillimore. Bujqësia kontribuon me përafërsisht 25 % në Bruto Prodhimin Vendor të Kosovës, punëson në mes të 25% deri 30% të punësimit të përgjithshëm, kryesisht në sektorin joformal, dhe përbën rreth 16% të vlerës së eksportit total¹.

Vizioni i përgjithshëm për bujqësinë dhe zhvillimin rural në Kosovë është “T’i jepet kontribut i ekuilibruar ekonomisë, ambientit, shoqërisë dhe mirëqenies kulturore të zonave rurale dhe Kosovës si tërësi, me anë të partneritetit efektiv dhe fitimprurës në mes të sektorit privat, qeverisë qendrore/lokale dhe komuniteteve lokale brenda kontekstit Evropian.”

Objektivat e përgjithshme të ministrisë së bujqësisë, pylltarisë dhe zhvillimit rural janë:

- Rritja e të ardhurave për bujqit dhe banorët ruralë përmes rritjes së prodhimtarisë, që do të ndikonte direkt në zbutjen e varfërisë dhe përmirësimin e standardit dhe kushteve të jetesës dhe të punës në zonat rurale,
- Përmirësimi i aftësisë konkurruese dhe efikasiteti i prodhimeve primare bujqësore me qëllim që të arrihet zvogëlimi i importit dhe rritja e eksportit,
- Përmirësimi i përpunimit dhe tregtimit të prodhimeve bujqësore, nëpërmes efikasitetit dhe rritjes së aftësisë konkurruese,
- Përmirësimi i cilësisë dhe standardeve higjienike në fermë/në fabrikë,
- Zhvillimi i qëndrueshëm rural dhe cilësia e përmirësuar e jetës (përfshirë infrastrukturën) nëpërmes të promovimit të bujqësisë dhe aktiviteteve të tjera ekonomike jashtë ferme që janë në harmoni me ambientin,
- Krijimi i mundësive të punësimit në zonat rurale, veçanërisht nëpërmes të diversifikimit të aktiviteteve rurale dhe rreshtimi i bujqësisë së Kosovës me atë të BE.

¹ Plani I Zhvillimit Rural dhe Bujqësor 2007-2013

Objektivat e lartpërmendur të politikave janë në harmoni me prioritetet e PVPE (Plani i Veprimit për Partneritet Evropian) për sektorin e bujqësisë, e në veçanti, PPE (Prioritetet e Partneritetit Evropian) 61 dhe 63 janë të lidhura me këtë fushë.

Realizimi i objektivave të lartpërmendura do të arrihet përmes aplikimit të masave më poshtë të elaboruara.

Ofrimi i trajnimeve profesionale dhe shërbimeve këshillimore bujqësore dhe rurale, ristrukturimi i potencialit fizik në sektorin agro-rural, përmes konsolidimit të tokës, investimi në makineri dhe pajisje të ndryshme në nivelin e fermës do të ngrit dukshëm produktivitetin në këtë fushë.

Rritja e produktivitetit në këtë sektor po ashtu do të ndihmohet përmes menaxhimit të burimeve të ujit për bujqësinë, investimeve në sistemet e përgjithshme të ujitjes (niveli primar dhe sekondar) si dhe në nivelin e fermës.

Përmirësimi i përpunimit dhe tregtimit të produkteve bujqësore, duke promovuar prodhimet me vlerë të lartë, që përmbushin standardet ndërkombëtare të higjienës, sigurisë dhe cilësisë së ushqimit për konsumatorët.

Promovimi, marketingu dhe etiketimi i prodhimeve cilësore vendore që nuk e dëmtojnë ambientin, duke aplikuar standarde veterinarë dhe fitosanitare të certifikimit.

Përmirësimi i menaxhimit të burimeve natyrore përmes pyllëzimit për herë të parë në tokat bujqësore me vlerë të ulët të prodhimit bujqësor, përmirësimet në biodiversitetin, në pyjet ekzistuese dhe zbatimi i skemave të mbrojtjes të “Natura 2000”.

Diversifikimi i fermave dhe aktiviteteve alternative në zonat rurale përmes promovimit të iniciativave dhe turizmit rural si në nivelin e fermës, ashtu edhe në atë të fshatit-komunitetit.

Promovimi dhe etiketimi i prodhimeve me origjinë vendore, duke stimuluar kalimin nga prodhimtaria tradicionale në atë organike.

Përkrahja për strategjitë zhvillimore të komuniteteve lokale, krijimi dhe veprimi e Grupeve Lokale të Veprimit (GLV), dhe mbështetje në përgatitjen e Planeve të Zhvillimit të Zonave të komunitetit në nivelin e fshatit, (ky aktivitet është duke u realizuar).

Sfidat kryesore të cilat MBPZHR do t'i adresojë si prioritete për periudhën afatmesme janë: Konsolidimi dhe mbrojtja e tokës bujqësore nga ndërtimet e egra, zgjerimi dhe riparimi i sistemit të ujitjes, krijimi i vendeve të punës në zonat rurale/ diversifikimi i fermës, siguria dhe kontrolli i cilësisë së ushqimit, ripyllëzimi i sipërfaqeve pyjore dhe stimulimi i prodhimitarisë bujqësore (me mundësi subvencionimi në partneritet me Bashkimin Evropian dhe donatorët tjerë).

3.1.6 Politika tatimore dhe administrimi

Qeveria e Kosovës është e përkushtuar drejt shqyrtimit të sistemit tatimor të Kosovës, me qëllim të përmirësimit të shkallës konkurruese në raport me vendet e regjionit. Ne zotohemi gjithashtu për krijimin e një mjedisi të favorshëm për investime dhe rritje. Tani jemi duke rishikuar politikat tona fiskale, që do të na lejojë vlerësimin e shkallës konkurruese të Kosovës në rajon, pa rrezikuar qëndrueshmërinë buxhetore të Kosovës.

Ky shqyrtim i sistemit tatimor bëhet në rrethana ku vendet fqinje të Ballkanit kanë orientuar përpjekjet e tyre drejt tërheqjes së investimeve të jashtme direkt, përmes normave joshëse tatimore, veçanërisht normave të ulëta për tatimin në korporata. Shqyrtimi i sistemit tatimor duhet të marrë parasysh këtë fakt.

Kosova momentalisht ka një sistem relativisht të thjeshtë tatimor, i bazuar në taksa uniforme dhe gjithëpërfshirëse. Kjo formë do të ruhet në një masë të madhe, por duke qenë se ka

kaluar mjaft kohë nga themelimi i sistemit ekzistues tatimor, do të punojmë në drejtim të asaj që sistemi tatimor të përkojë me realitetin e ri ekonomik.

Ndryshimet e propozuara fiskale do të orientohen në dy fronte. Në njërin anë, normat tatimore do të jenë stimuluese për biznesin dhe konkurruese me regjionin, kurse në anën tjetër, do të shqyrtohen problemet e identifikuar administrative.

Qëllimi përfundimtar i politikave fiskale është rritja e qëndrueshme ekonomike, prandaj përpjekje do të bëhen që sistemi tatimor të ndihmojë efikasitetin ekonomik. Qeveria po ashtu do të ketë gjithmonë parasysh çështjet e barazisë dhe administrimit, në mënyrë që kjo reformë të ketë sukses. Së fundmi, reforma fiskale do të jetë neutrale sa i përket të hyrave buxhetore, çka do të sigurojë qëndrueshmërinë buxhetore.

3.1.7 Sektori financiar

Sistemi financiar, paraqet një ndër sektorët me zhvillimin më të hovshëm në ekonominë e vendit. Në veçanti, sektori bankar i Kosovës, që gjithsej numëron 7 banka komerciale, radhitet ndër më të mirët në regjion, si për nga shkalla e zhvillimit ashtu edhe besimit që ekziston për të.

Trendet në sektorin bankar tregojnë se ka një rritje të vazhdueshme të depozitave dhe kredive. Tregu është mjaft dinamik, gjë që shihet nga hyrja e disa bankave të reja dhe bashkimi i disa tjerave kohëve të fundit.

Megjithatë, duke qenë se paraqet një sektor në zhvillim, sistemi financiar i Kosovës ka hapësirë për t'u përmirësuar. Në veçanti, ekziston një mendim i përgjithshëm se normat e interesit janë relativisht të larta, dhe jo shumë stimuluese për investimet. Mënyra e vetme për të pasur norma më të ulëta të interesit, është përmes rritjes së konkurrencës dhe krijimit të një ambienti të sigurt për veprimtarinë e bizneseve bankare. Në këtë kontekst, Qeveria do të punojë në drejtim të forcimit dhe funksionalizimit të Gjykatave, kompletimin e kornizës

ligjore dhe forcimin e mëtutjeshëm të Autoritetit mbikëqyrës të këtij sistemi. Kjo do të krijonte kushte më të mira për operim dhe si rezultat do të mund të ndikonte pozitivisht në uljen e normave të interesit.

Nga ana tjetër, procesi i konsolidimit të sistemit bankar në të ardhmen do të rezultojë edhe me ofrimin e produkteve të reja, që do të shkonin në dobi të biznesit. Në momentin e tanishëm ka përmirësim në këtë drejtim, por ky progres ende nuk është i mjaftueshëm.

Mirëpo liberalizimi i tregut dhe ofrimi i produkteve të reja me vete sjellin dhe sfida të reja, në radhë të parë, në monitorimin e sistemit financiar dhe shmangien e problemeve strukturale. Në këtë drejtim, në vitet në vijim duhet bërë fuqizimi i Autoritetit Qendror Bankar, në mënyrë që ky i fundit, përmes operimit si Bankë Qendrore, të sigurojë qëndrueshmërinë dhe stabilitetin e sistemit financiar.

3.2 Implementimi i statusit

Më 17 shkurt 2008, Kosova i dërgoi komunitetit ndërkombëtar një mesazh të fuqishëm që synimi i saj parësor është krijimi i shtetit funksional demokratik, ekonomikisht të qëndrueshëm dhe shumë-etnik. Sikur është deklaruar shumë herë nga institucionet dhe populli i Kosovës, ne jemi të zotuar për implementimin e plotë të marrëveshjes së statusit. Do të vazhdojmë me forcimin e partneriteti tonë me komunitetin ndërkombëtar në arritjen e këtij synimi.

Përmes asistencës ndërkombëtare, Kosova aktualisht po shqyrton koston e arritjes dhe menaxhimit të statusit të saj të ri. Jemi duke krijuar institucionet e reja në nivel qendror dhe lokal. Kosova tanimë ka lidhur marrëdhënie diplomatike me shumë qeveri nëpër botë, dhe do të krijojmë praninë tonë diplomatike të ato vende. Jemi duke punuar për formimin e Forcës së Sigurisë, që do të shtrojë nevojën për transformim të TMK-së në forcë të re profesionale. Jemi duke krijuar gjithashtu komunat e reja dhe po bëjmë decentralizimin e funksioneve, në mënyrë që qeveria të jetë më afër qytetarëve.

Jemi të përkushtuar plotësisht për sigurim të standardeve më të larta për të drejtat e minoriteteve në Kosovë, dhe shumë prej këtyre të drejtave janë mbi standardet e shumë vendeve demokratike perëndimore. Duam të forcojmë integrimet rajonale me të gjithë fqinjët tanë drejt synimit tonë të përbashkët të anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

Në kuadër të pakos për implementimin e statusit, vëmendje e veçantë to t'u kushtohet: Decentralizimit, fushës së Sigurisë, krijimit të institucioneve të reja dhe Minoriteteve

3.2.1 Decentralizimi

Duke cituar pakon e Ahtisaarit, decentralizimi ka për qëllim promovimin e qeverisjes së mirë, transparencën, efikasitetin dhe qëndrueshmërinë e shërbimeve publike. Nga obligimet që dalin prej Dokumentit gjithëpërfshirës për zgjedhjen e statusit të Kosovës (Pakoja e Ahtisarit Anexi III për decentralizimin, që është miratuar nga Kuvendi i Kosovës), është përgatitur Plani Aksional për Decentralizim, që parasheh këto masa:

- Themelimin e një Grupi Ndërmintor për Decentralizim (GND), si trupi më i lartë politik për të udhëhequr gjithë procesin e decentralizimit.
- Themelimin e katër nëngrupeve punuese të cilat do të bartin çështjet që shtrohen në fazën e implementimit të 5+1 Komunave të reja dhe funksionalizimin e 3 Pilot Njësieve Komunale që shndërrohen në komuna me të drejta të plota me hyrjen në fuqi të Ligjit për Kufijtë Administrativë të Komunave.
- Një fushatë informuese për decentralizimin, që do të startojë pas bisedimeve në nivel Qeveritar.

3.2.2 Krijimi i një ambienti të sigurt në Kosovë

Në bazë të pakos së Ahtisaarit, Qeveria e Kosovës do të themelojë Këshillin e Sigurisë së Kosovës, Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Agjencinë e Inteligjencës, të cilët do të sigurojnë një përgjegjësi më të madhe në fushën e sigurisë. Sfidat kryesore është krijimi i sistemeve të integruara dhe plotësuese për njëra tjetrën, të cilat e forcojnë dhe jo mbivendosen mbi njëra tjetrën.

Këshilli i sigurisë së Kosovës do të formohet për të ndërtuar një strategji të gjithëmbarshme të sigurisë. Forcat e Sigurisë së Kosovës do të jenë forcë profesionale dhe shumë-etnike.

3.2.3 Integrimi i Komuniteteve dhe Kthimi i të Zhvendosurve

Qeveria e Kosovës është e përkushtuar për një shoqëri multietnike, dhe zotohet për përkrahjen e vazhdueshme për integrimin e komuniteteve, qëndrimin dhe kthimin e qëndrueshëm të të gjithë të zhvendosurve.

Synimet kryesore të Qeverisë në këtë fushë janë:

1. Përkrahja konkrete e zhvillimit dhe integrimin të bashkësive etnike.
2. Përkrahja dhe financimi i kthimit të qëndrueshëm individual dhe të organizuar.
3. Angazhimi dhe koordinimi i aktiviteteve për fondet shtesë, përveç nga buxheti i Kosovës, për kthimin, zhvillimin dhe integrimin e komuniteteve.

Realizimi i këtyre tri synimeve kryesore, do bëhet përmes:

1. Bashkëpunimin me partnerët vendor:
 - institucionet qendrore, posaçërisht me ministrinë, puna e të cilave është e gërshetuar me kompetencat e MKK-së,
 - bashkëpunimi me komunat,
 - bashkëpunimi me organizata joqeveritare,

- bashkëpunimi me shoqërinë civile,
- përkrahja dhe iniciativa për dialog në mes të bashkësive kthye dhe pranuese,
- përcjellja e realizimit të planit të strategjive të komunave për kthim.

2. Bashkëpunimi me partnerët ndërkombëtarë:

- Përfaqësitë diplomatike të shteteve të jashtme, të cilat janë të hapura në Prishtinë.
- Organizatat ndërkombëtare që shquhen me kontribut në trajtimin e komuniteteve dhe procesin e kthimit, si: UNMIK - u, UNHCR - i, OCR- ja, UNDP - ja, OEBS - i.
- Organizatat tjera ndërkombëtare.

3. Konferenca e donatorëve dhe fonde tjera nga institucione vendore dhe ndërkombëtare.

Platforma e Qeverisë do të jetë e orientuar në projekte për zhvillimin e komuniteteve dhe integrimin e tyre në institucionet dhe shoqërinë kosovare.

Qeveria e Kosovës në periudhën e ardhshme krahas kthimit të organizuar, do t'i kushtojë vëmendje edhe kthimit individual, i cili është më i lirë, i suksesshëm dhe më shpejt i realizueshëm.

Qeveria e Kosovës gjatë shpërndarjes së buxhetit për investime kapitale do të ketë parasysh:

- Përbërjen e strukturës nacionale të popullsisë pakicë,
- Faktorin gjeografik,
- Prioritetet sipas rasteve më urgjente.

3.2.4 Politika e Jashtme e Republikës së Kosovës

Në fushën e politikës së jashtme, si dhe të marrëdhënieve dhe bashkëpunimit ndërkombëtar, Qeveria e Kosovës do të jetë e angazhuar në:

- Përshpejtimin e procesit të njohjes ndërkombëtare të shtetit të pavarur dhe sovran të Kosovës,

- Thelimin e marrëdhënieve të veçanta me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, shtetet e BE-së, shtetet fqinje dhe vendet tjera.
- Ndërtimin e Shërbimit Diplomatik dhe Konzular të Kosovës,
- Anëtarësimin e plotë të vendit në organizatat dhe institucionet kryesore politike, ekonomike dhe financiare ndërkombëtare,
- Mbrojtjen e interesave të qytetarëve të Kosovës në botën e jashtme,
- Afirmimin e identitetit të veçantë të Kosovës.

Prioritetet i Qeverisë së Kosovës është kompletimi i strukturës dhe funksionalizimi i plotë i Ministrisë së Punëve të Jashtme, deri në marrjen e kompetencave të plota në këtë fushë nga prania civile ndërkombëtare.

Pastaj vjen vendosja e misioneve të përhershme të Kosovës në organizatat kryesore ndërkombëtare: OKB, BE, NATO dhe OSBE.

Qeveria e Kosovës është e vetëdijshme për gamën e ligjeve që duhet të harmonizohen me standardet e BE-së, si dhe vëllimin e reformave që duhet të ndodhin në të gjitha fushat për t'i plotësuar kriteret që kërkohen nga Bashkimi Evropian në procesin e Stabilizim- Asociimit.

Një prioritet tjetër në fokus të përhershëm të Qeverisë së Kosovës do të jetë anëtarësimi i Kosovës në NATO. Natyrisht, kjo është një sfidë e veçantë e cila kërkon reforma të gjithanshme në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes. Megjithatë, Qeveria e Kosovës do t'i japë prioritet angazhimit për nënshkrimin sa më shpejt të Partneritetit për Paqe me NATO-n.

Një provë për shtetin e ri të Kosovës do të jetë anëtarësimi në OKB. Qeveria e Kosovës do të rekomandojë dhe do të zbatojë një fushatë intensive dhe të fuqishme lobimi për të fituar përkrahjen e nevojshme për anëtarësim në këtë organizatë prestigjioze.

Sipas prioriteteve Kosova do të bëjë nënshkrimin dhe ratifikimin e konventave dhe deklaratave ndërkombëtare në këto fusha:

- Zhvillimin e marrëdhënieve ndërkombëtare,
- Të drejtat e njeriut dhe pakicave,
- E drejta humanitare ndërkombëtare,
- Mbrojtje të ambientit dhe planifikimit hapësinor,
- Ekonomi,
- Bashkëpunim ndërkombëtar në zbatimin e ligjit dhe asistencë juridike,
- Arsim, shëndetësi dhe çështje sociale, etj.

3.3 Qeverisja e mirë

Qeveria e Kosovës ka si prioritet përmirësimin e performancës së mëtutjeshme të institucioneve qeveritare, në veçanti të atyre që merren me mbledhjen dhe shpenzimin e parasë publike. Përcaktimi qartë i kompetencës dhe përgjegjësisë në të gjitha fushat dhe të gjitha veprimtaritë.

Kemi një nga shërbimet më të mira doganore në rajon. Të gjitha të hyrat dhe shpërndarja e tyre janë të kanalizuar përmes Llogarisë së vetme të Thesarit, dhe janë të instaluar sistemet e auditimit-raportimit. Megjithatë, jemi të vetëdijshëm që kemi një rrugë të gjatë para nesh. Jemi të përkushtuar të vazhdojmë me sukseset e arritura deri tani dhe të adresojmë mangësitë e identifikuar në Vlerësimin Financiar dhe atë të Shpenzimeve Publike (PEFA). Luftimi i korrupsionit do të jetë një nga prioritetet e Qeverisë së Kosovës.

Kemi nisur procesin e Reformave në Administratën Publike. Në javët që vijnë, Kosova do të fillojë Rishikimin funksional, që ka për synim përmirësimin e strukturës së qeverisë së Kosovës, për të ofruar shërbime më të mira për qytetarët. Jemi të interesuar gjithashtu në programet për të ndaluar “Ikjen e Trurit”, dhe për të tërhequr individët me kualifikime të larta në sektorin publik.

Ne e kuptojmë mirë që kapaciteti ynë për shpenzim të ndarjeve buxhetore të aprovuara është i dobët. Ky kapacitet i vogël për shpenzime është rezultat i shumë faktorëve që i kemi

identifikuar në aktivitetet e përbashkëta me Bankën Botërore. Tanimë kemi nisur implementimin e rekomandimeve të këtij studimi.

Në kuadër të fushës së Qeverisjes së mirë, në fokus do të jenë:

- Reforma në Administratën Publike,
- Menaxhimi i Financave Publike,
- Luftimi i Korrupsionit,
- Përmirësimi i ekzekutimit të shpenzimeve kapitale,
- Reforma në Administratën Publike.

3.3.5 Reforma në Administratën Publike

Reforma e Administratës Publike, si një nga standardet për integritet Evropianë përfshinë veprimet: a) rishikimi funksional, b) kompletimi i infrastrukturës ligjore për Shërbimin Civil të Kosovës, c) hartimi i strategjisë për arritjen e objektivave të trajnimit, d) avancimi i sistemit të pagave, e) krijimi i sistemit modern të menaxhimit të personelit, f) përkufizimi i kompetencave thelbësore për kuadrot e larta në SHCK.

Qeverisja elektronike (e-Qeverisja): për arritjen e këtij synimi do të bëjmë hartimin dhe zbatimin e strategjisë për Qeverisje elektronike. Me realizimin e kësaj strategjie synohet të përmirësohet kualiteti i shërbimeve qeveritare përmes: a) kompletimit të legjislacionit në fushën e teknologjisë së informacionit, b) ofrimit të shërbimeve elektronike për qytetarët dhe bizneset, c) krijimit të Qendrës së të Dhënave, d) funksionalizimit të e-Portalit shtetëror që do t'i shërbejë një transparence dhe efikasiteti të institucioneve publike, e) fuqizimit të rrjetit qeveritar dhe masivizimit të përdorimit të internetit dhe intranetit, f) zhvillimit dhe aplikimit të standardeve për harduer dhe softuer, g) realizimit të funksionimit reciprok në mes të sistemeve që aplikohen në punën e administratës publike dhe g) avancimit të Sistemit dhe Shërbimeve të Kadastrave.

Sigurimi i infrastrukturës së nevojshme fizike për një funksionim efikas të institucioneve të Republikës së Kosovës. Arritja e këtij synimi do të realizohen përmes këtyre ndërtimit të kompleksit të ndërtesave qeveritare. Objektivat strategjike të këtij prioriteti janë në përputhje me Reformën e Administratës Publike dhe si të tilla kanë për qëllim a) marrjen dhe menaxhimin e godinave dhe hapësirave publike të cilat në procesin e tranzicionit UNMIK-u do t'ia transferojë Qeverisë së Republikës së Kosovës, b) adoptimin dhe akomodimin e përkohshëm të disa institucioneve në kompleksin ish-Rilindja, dhe d) zvogëlimin e shpenzimeve në mirëmbajtjen e komplekseve ndërtimore.

3.3.6 Menaxhimi i Financave Publike

Një nga objektivat thelbësore të Qeverisë është të mbajë dhe përmirësojë edhe më tutje procesin e tanishëm buxhetor, të rris kredibilitetin e institucioneve qeveritare që merren me mbledhjen dhe shpenzimin e parasë publike; të rris transparencën dhe llogaridhënien e këtyre institucioneve, të përmirësojë planifikimin e shpenzimeve të bazuara në politika të mirëfillta publike si dhe përmirësojë edhe më tutje procesin e auditivit dhe kualitetin e raportimit.

Në këtë drejtim, me asistencën e Bankës Botërore, është përgatitur dokumenti mbi Vlerësimin e Shpenzimeve Publike dhe Përgjegjësiive Financiare (PEFA). Qëllimi i përgatitjes së këtij dokumenti është që nëpërmes analizimit të indikatorëve të caktuar në kuadër të shpenzimeve publike të bëjë të mundur identifikimin e fushave të caktuara për të cilat vlerësohet se kërkohet përmirësim në të ardhmen. Kjo pra do të thotë një vlerësim i strukturuar i sistemit të menaxhimit të financave publike në Kosovë.

Në përgjithësi ky raport vë në dukje rezultatet e arritura deri me tani sa i përket menaxhimit të shpenzimeve publike dhe përgjegjësiive financiare, dhe ka vlerësuar së fundi se Kosova nëpërmes Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave ka arritur të krijojë një disiplinë dhe një rregull sa i përket kësaj fushe.

Përderisa një numër i indikatorëve janë vlerësuar pozitivisht, ekziston një numër i atyre që kërkojnë përmirësim. Në këtë drejtim, MFE ka përgatitur edhe Planin veprimin për përmirësimin e indikatorëve në mënyrë që vlerësimet e ardhshme të jenë në nivel më të mirë.

Prandaj, Qeveria e Kosovës është e përkushtuar të implementojë plan veprimin e përgatitur nga MEF-i, i cili reflekton rekomandimet e PEFA-s për përmirësimin e menaxhimit të financave publike.

3.3.7 Luftimi i korrupsionit

Mangësitë e theksuara në raportet e Zyrës së Auditorit Gjeneral, përfshinë shkeljet e ligjit, si: nënshkrimi i kontratave para zotimit të fondeve, mungesa e dokumenteve të prokurimit, përdorimi i procedurave të negociuara (jo-konkurrese) etj. Është e qartë që praktikat e tilla e nënvlerësojnë parimin e ekonomisë në shpenzimet e resurseve publike.

Për të eliminuar këto parregullsi, Qeveria e Kosovës ka filluar të ndërmarrë hapa të rëndësishëm për të përmirësuar sistemin e prokurimit publik, forcimin dhe trajnimin e vazhdueshëm detyrues si dhe certifikimin e zyrtarëve të prokurimit.

Qeveria do të mbështesë iniciativat e ndërmarra dhe Strategjinë kundër Korrupsionit në Kosovë të zhvilluar tashmë dhe do të ndërmarrë masa konkrete për të shtyrë përpara zhvillimin e mëtejshëm të infrastrukturës institucionale dhe ligjore, në funksion të luftimit të dukurisë së korrupsionit në çdo fushë.

Qeveria do të bashkëpunojë dhe forcojë partneritetin me shoqërinë civile dhe mediet për të fuqizuar rolin e tyre në zhvillimin, zbatimin dhe monitorimin e reformave kundër korrupsionit dhe në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies së organeve Qeveritare dhe jo-qeveritare në Kosovë.

3.3.8 Përmirësimi i ekzekutimit të shpenzimeve kapitale

Shkalla e ulët e ekzekutimit të shpenzimeve është sfidë për pothuaj të gjitha vendet në zhvillim. Në këtë rast, Kosova nuk është një përjashtim. Gjatë viteve të kaluara, niveli i shpenzimeve për investime kapitale nuk ka qenë i kënaqshëm.

Për shkak se buxheti i Kosovës është i bazuar në sistemin e parave të gatshme, eliminimi i tërësishëm i nënshpenzimeve pothuajse do të jetë i pamundur. Ky sistem buxhetor posaçërisht ndikon në planifikimin e projekteve kapitale, që duhet të planifikohen në faza dhe segmente të caktuara për qëllime të buxhetit, me qëllim të përshtatjes së shpenzimeve të parashikuara me shumatat e kërkuara dhe të siguruara për vitin vijues. Problemet do të jenë më të mëdha për projektet kapitale dhe prokurimet e mëdha, disa vjeçare.

Në këtë drejtim, Qeveria do të implementojë rekomandimet e dala nga raporti i MEF-it mbi “Arsyet e identifikuara për nënshpenzime në kategorinë e shpenzimeve kapitale” për vitin 2006, si dhe ato të dala nga raporti i Bankës Botërore mbi ‘Menaxhimin e Financave Publike’.

Sipas këtyre raporti disa nga arsyet e nënshpenzimeve kryesisht mund të përmbliidhen në këto pika:

- Planifikimi jo i kënaqshëm i projekteve dhe kryesisht planifikim vjetor dhe jo shumëvjeçar.
- Afatet e stërzgjatura të procedurave të prokurimit, si dhe mosnjohja e procedurave të prokurimit nga zyrtarët e prokurimit:
- Ekzekutimi dhe monitorimi i projekteve ishte i dobët.

Pritet që shkalla e shpenzimit të stabilizohet dhe të rritet ngadalë gjatë viteve të ardhshme deri në arritjen e një shkalle e cila do të jetë e krahasueshme me shtetet në regjion. Megjithatë, kjo natyrisht që varet nga shumë faktorë siç janë niveli i optimizimit gjatë buxhetimit, ndërlikueshmëria e projekteve kapitale, procedurat dhe suksesi në prokurim,

fleksibiliteti në alokimin e buxhetit ndërmjet projekteve të ndryshme, vlerësimet e kohëzgjatjeve të projekteve, dhe vonesat e projekteve për shkak të faktorëve të jashtëm.

Aktivitet e ndërmarra nga institucionet qeveritare:

- Mungesa e orientimit afatgjatë në perspektiven fiskale dhe planifikimit shumëvjeçar tani është duke u adresuar përmes përgatitjes së KASH-it 2009-2011, ndërsa që një projekt i Asistencës Teknike të Planit dhe Strategjisë Zhvillimore të Kosovës, i menaxhuar nga Agjencioni Evropian për Rindërtim, është duke asistuar ministrinë kryesore në Qeverinë e Kosovës në zhvillimin e funksionit të planifikimit strategjik, me qëllim të ngritjes së kapaciteteve të identifikimit, planifikimit, prioritizimit dhe buxhetimit të projekteve të rëndësishme. Procesi, gjithashtu, shërben si mjet për përcaktimin e synimeve të Qeverisë rreth politikave, dhe u ndihmon donatorëve në përpjekjet e tyre për identifikimin dhe përkrahjen e projekteve investuese të prioritetit të lartë.
- Në fushën e prokurimit janë bërë ndryshime në Ligjin për Prokurim Publik (LPP), duke shkurtuar kështu të gjitha afatet e tenderimit dhe zvogëluar procedurat e prokurimit nga shtatë sa ishin në gjashtë procedura. Më tutje, është bërë thjeshtësimi i LPP-se dhe disa funksione të Agjencionit të Prokurimit Publik dhe MEF-it janë bartur në KRPP. Autoriteteve kontraktuese u jepet pavarësi më e madhe për zgjedhjen e procedurave të prokurimit.
- Në fushën e planifikimit kërkohet nga OB që ta tregojnë qartazi, në dorëzimet e tyre buxhetore, se a janë projektet, për të cilat kërkohen mjetet, të gatshme për t'u zbatuar, në kontekst të pasjes së mjeteve në dispozicion, nëse ka zotime të domosdoshme nga donatorët, bashkë-financim dhe dokumentacion adekuat të pronësisë, si dhe nëse janë përpiluar të gjitha specifikimet teknike për prokurim dhe planifikimet tjera preliminare për projektin.
- Të renditen projektet kapitale, në procesin e PIP-it në bazë jo vetëm të politikave prioritare, por edhe sipas asaj renditjeje se a janë të gatshme për t'u zbatuar.

Të sigurohet një kontroll i përforcuar ex-ante (paraprak) i zotimeve që kërkojnë prokurimin nëpërmes të modulit të ri të prokurimit, si dhe të ofrohen udhëzime vijuese.

3.4 Zbutja e varfërisë dhe stabiliteti social

Përbrenda një kornize të qëndrueshme fiskale të prezantuar në KASh, Kosova është e përkushtuar në zhvillimin dhe analizimin e opsioneve për përmirësim të kushteve për personat në pozitë më të pafavorshme. Sikur është theksuar më herët, marrë parasysh shkallën e problemit, kjo detyrë është një prioritet i përhershëm në periudhën afatgjatë. Kemi për synim të punojmë ngushtë me partnerët tanë në komunitetin ndërkombëtar në zhvillimin e reformave strukturale për përmirësim të këtyre treguesve.

Zbutja e varfërisë dhe mirëqenia sociale do të arrihet duke përmirësuar cilësinë shërbimeve në këto fusha:

- Pensionet dhe transferet tjera sociale
- Shëndetësia

3.4.3 Pensionet dhe transferet tjera sociale

Qeveria e Kosovës është e përkushtuar që të përmirësojë mirëqenien e qytetarëve të saj përmes politikave të dizajnuara mirë sociale. Në këtë kontekst, çështjet që kanë të bëjnë me fushën e mbrojtjes sociale do të adresohen përmes këtyre synimeve:

Ndihmave sociale për familjet e varfra: Qëllim kryesor është të mbahet një sistem i mbrojtjes sociale, që targeton të gjithë personat të cilët nuk mund t'i ndihmojnë vetvetes dhe familjes, e për të cilët Qeveria përmes institucioneve përgjegjëse do të ju ofrojë ndihmën dhe garantimin e të ardhurave minimale për jetesë. Parimi kryesor i mbrojtjes sociale është sigurimi i jetesës me dinjitet dhe shërbime për ata që kanë nevojë për ndihmë.

Sistemi i mbrojtjes sociale do të zhvillohet në linjë me këto synime:

- Përmirësimi i kushteve të jetesës përmes ndihmës sociale për familjet e varfra në mënyrë që familja të fuqizohet,
- Ndihmë për kujdesin shëndetësor dhe shkollim të fëmijëve që jetojnë në varfëri (lirimi nga pagesa e shërbimeve shëndetësore dhe furnizimi me libra për fëmijë),
- Ofrimi i ndihmave dhe shërbimeve plotësuese për familje dhe individ përmes kontraktimit dhe marrëveshjeve me OJQ-të.

Avancimi i shërbimeve sociale për individ dhe grupe me nevoja urgjente: Me rastin e dështimit të familjes në përmbushjen e obligimeve, Qeveria do të angazhohet të ofrojë përkujdesjen e nevojshme për individin dhe familjen (mbrojtjen e fëmijëve, të rriturve dhe personave të moshuar).

Për arritjen e këtij synimi MPMS-ja është përcaktuar për këto masa:

- Mbrojtja e fëmijëve pa përkujdesje familjare përmes formave të bashkimit familjar, kujdestarisë, strehimit familjar, adoptimit dhe strehimit të përkohshëm institucional.
- Përkujdesja për fëmijët e abuzuar dhe të keqtrajtuar si dhe për ata me aftësi të kufizuara fizike dhe mendore.
- Përkrahja materiale e personave me aftësi të kufizuara të përhershme fizike dhe mendore.
- Mbrojtja e viktimave të dhunës në familje dhe viktimave të trafikimit me qenie njerëzore
- Barta e kompetencave për ofrimin e shërbimeve sociale nga niveli qendror në nivel lokal

Sistemi Pensional: Vazhdimi i sigurimit të pagesave të pensioneve dhe shikimi i mundësive për harmonizimin e vlerës së shportës së ushqimit në përputhje me trendin kohor të çmimeve si dhe pagesa e pensionit suplementar për kontribut dhënësit në ish sistemin e kaluar pensional.

3.4.4 Shëndetësia

Krijimi i sistemit të qëndrueshëm të financimit për sektorin shëndetësor si dhe identifikimi i metodologjisë së financimit të qëndrueshëm që do të mundësojë përmirësimin e gjendjes shëndetësore të popullatës, është prioritet në këtë sektor. Mbledhja dhe shpenzimi i burimeve, do të bazohet në zgjedhjen e alternativave moderne dhe efikase, duke u mbështetur në përkushtimin e Qeverisë për rritjen e buxhetit për shëndetësi.

Qeveria do të angazhohet të aplikojë ligjin e sigurimeve shëndetësore, dhe do të përshtatet me mundësitë reale të implementimit.

Do të shqyrtohen mundësitë që profesionistët shëndetësorë të shpërblehen për ofrimin e kujdesit shëndetësor cilësor.

Qeveria do të angazhohet për jetësimin e projektit për metodologjinë e financimit, përcaktimin e pakos bazike të shërbimeve shëndetësore, përcaktimin e kostos së shërbimeve shëndetësore dhe procedurave mjekësore, të cilat do të shërbejnë për përgatitjen e kushteve për implementim të sigurimit shëndetësor.

Synimet kryesore të sektorit të shëndetësisë janë:

Zvogëlimi i sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë së popullatës (përmes zhvillimit të shërbimeve shëndetësore): Me këtë objektivë synohet ulja e përqindjes së morbiditetit dhe mortalitetit, përmes ngritjes së kualitetit, sipas standardeve bashkëkohore të shërbimeve shëndetësore, në radhë të parë përmes fuqizimit të Kujdesit parësor shëndetësor/mjekësisë familjare si bazë e sistemit shëndetësor.

Riorganizimi dhe funksionalizimi i Kujdesit dytësor shëndetësor dhe Kujdesit tretësor shëndetësor me qëllim të ofrimit sa më të mirë të shërbimeve shëndetësore.

Përmirësimi i vazhdueshëm i menaxhimit të resurseve ekzistuese dhe cilësisë së shërbimeve: Qëllim i këtij objektivi strategjik do të jetë promovimi i menaxhimit të bazuar në ekonominë shëndetësore, decentralizimi i menaxhimit dhe vendimmarrjes, investimi dhe shpërndarja e buxhetit në bazë të kosto-eficencës dhe të dhënave objektive.

Menaxhimi do të bazohet në kriterin që spitalet dhe institucionet tjera shëndetësore të konceptohen si “ndërmarrje që prodhon shëndetin”, çka do të orientojë në menaxhimin më të mirë të resurseve.

Do të bëhet decentralizimi i buxhetit, resurseve njerëzore dhe investimeve. Resurset do të përdoren duke llogaritur vlerën për kosto të investuar me tregues menaxherial dhe në bazë të kriterëve kosto-eficencë.

Do të zhvillohen kapacitetet njerëzore në menaxhimin bashkëkohor të institucioneve.

Zhvillimi i vazhdueshëm i njohurive dhe shkathtësive profesionale të të gjithë profesionistëve shëndetësorë duke përcjellë trendet bashkëkohore.

Funksionalizimi dhe zhvillimi i Sistemit të Informimit Shëndetësor: Menaxhimi i Sistemit të Informimit Shëndetësor do të bazohet në krijimin e strukturave të informacionit shëndetësor, të cilat do të jenë në gjendje të ofrojnë të dhëna për të analizuar situatën epidemiologjike dhe gjendjen shëndetësore të popullatës si dhe ofrimin e të dhënave për menaxhimin dhe planifikimin e menaxhimit ditor, afatmesëm e afatgjatë të institucioneve dhe sistemit shëndetësor.

Evidenca në sistemin shëndetësor, duke përfshirë atë klinike, të resurseve humane, financiare dhe farmaceutike, është faktor themelor për analizën e gjendjes shëndetësore të popullatës, menaxhimin e institucioneve në bazë të të dhënave dhe fakteve, përpilimin e politikave shëndetësore dhe planeve të implementimit.

Kjo detyrë kërkon krijimin e Sistemit të kompjuterizuar për menaxhimin e Informacionit Shëndetësor. Do të hartohet një projekt gjithëpërfshirës për të implementuar këtë prioritet.

Krijimi i rrjetit unik të Sistemit për Menaxhimin e Informacionit Shëndetësor, krijimi i kartelave elektronike me të dhënat klinike të pacientit dhe përpunimi i informacionit e të evidencës, janë bazë mbi të cilën do të përpilohen protokollat e kujdesit shëndetësor.

Në këtë sistem do të integrohet edhe Qendra e Telemjekësisë, e cila do të udhëheqë proceset e filluara në racionalizimin e shpenzimeve për shërbime, përfitimin në kohën e dhënies së shërbimeve konsultative, edukimin specialistik, format e tjera të edukimit në shëndetësi e në veçanti Zhvillimin e Vazhdueshëm Profesional në Mjekësi (ZHVP).

Në afat të shkurtër do të fuqizohet roli i Telemjekësisë, si departament përgjegjës për zhvillimet, implementimet, si dhe inovimet e teknologjisë së informacionit mjekësor, për nevojat e sistemit shëndetësor.

Funksionalizimi, riorganizimi dhe plotësimi i infrastrukturës ekzistuese të sistemit shëndetësor dhe sigurimi i pajisjeve në përputhje me standardet evropiane: Riorganizimi i shërbimit shëndetësor kërkon planin e shpërndarjes së institucioneve shëndetësore në të gjitha nivelet e kujdesit shëndetësor (master plani) që do të përfshijë sistemin shëndetësor publik dhe atë privat.

Master Plani do t'i sigurojë popullatës qasje të lehtë në institucionet shëndetësore në të gjitha nivelet. Institucionet do të koordinojnë planet e shpërndarjes së profesionistëve shëndetësorë dhe të resurseve tjera në harmoni me masterplanin.

Kujdesi spitalor do të funksionojë i integruar, si hallkë ndërlidhëse dhe bashkëpunimi në mes të Kujdesit tretësor dhe Kujdesit parësor shëndetësor. Këtij koordinimi për integrim duhet t'iu bashkohen Institutet dhe institucionet tjera të rehabilitimit dhe ato për përkujdesje sociale.

Zhvillimi i shëndetit publik përmes zgjerimit të programeve të promovimit shëndetësor për ruajtjen dhe përparimin e shëndetit të popullatës: Ministria e Shëndetësisë do të përqendrohet në planifikimin e politikave dhe të aktiviteteve të lidhura me shëndetin publik, përmes përgatitjes dhe zbatimit të strategjive dhe politikave shëndetësore: përcjelljes, identifikimit, korrigjimit dhe avancimit të faktorëve mjedisorë me ndikim në shëndet; identifikimit dhe luftimit të agjentëve infektivë që kërcënojnë shëndetin; nevojës për zgjerimin e programeve të promovimit shëndetësor për ruajtjen dhe përparimin e shëndetit të popullatës; zhvillimit dhe avancimit të punës kërkimore shkencore dhe profesionale.

Qeveria zotohet të fuqizojë sektorin publik dhe atë privat të shëndetësisë brenda kornizës ligjore.

4. Politikat tjera Qeveritare

4.1 Zhvillimi i Sektorit Privat

Duke marrë parasysh se orientimi përfundimtar i Kosovës është Bashkimi Evropian, mbikëqyrja dhe organizimi i tregtisë, pronësisë industriale, ndërtimtarisë, hotelerisë, industrisë, turizmit janë fusha me fokus të veçantë për Qeverinë. Kjo do të kërkojë zhvillimin dhe mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, promovimin e investimeve si dhe garantimin e tyre.

Qeveria e Kosovës për të realizuar këtë orientim do të angazhohet në këto fusha:

- Hartimi i Strategjisë së Zhvillimit të Sektorit Privat,
- Hartimi i strategjisë për promovimin e Investimeve Direkte të Huaja,
- Hartimi i Strategjisë së Zhvillimit të Turizmit të Kosovës,
- Strategjia e Zhvillimit Industrial, e cila do të shërbejë si bazë për zhvillimin ekonomik të Kosovës,
- Strategjia e Mësimimit të Ndërmarrësisë,

- Hartimi i projekt dokumentit “Programi Kosovar për Mbrojtjen e Konsumatorit”.

Këto veprime janë të domosdoshme për realizimin e synimeve të lartpërmendura:

- Përmirësimi i infrastrukturës ligjore,
- Përmirësimi i infrastrukturës Fizike për Zhvillimin e NVM-ve ku bëjnë pjesë Parqet Industriale, Zonat Industriale dhe Inkubatorët e Biznesit,
- Iniciativa për Promovimin e Ndërmarrësisë,
- Karta e Ndërmarrjeve të Vogla e të Mesme,
- Ofrimi i Qasjes në Trajnime dhe Këshillime për NVM,
- Implementimi i Kartës Evropiane i Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme,
- Stimulimi i rritjes së prodhimit me qëllim që të eksportohet për përmirësim të raportit tejet negativ në shkëmbimet tregtare,
- Promovimi i eksportit dhe plotësimi i kriterëve nga prodhuesit vendorë për të qenë konkurrues në tregun vendor dhe tregjet ndërkombëtare,
- Anëtarësimi i Zyrës së pronësisë industriale në WIPO (Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale) dhe EPO (Zyra Evropiane e Patentave),
- Plotësimi i infrastrukturës ligjore për Pronësinë industriale,
- Nënshkrimi i konventave të Evropiane të pronësisë intelektuale,
- Nënshkrimi i marrëveshjeve bilaterale dhe multilaterale të Pronësisë industriale,
- Zbatimi dhe monitorimi i marrëveshjes së CEFTA-s,
- Mbrojtja e konsumatorëve,
- Fillimi i procedurave dhe anëtarësimi në OBT si dhe trupat tjera ndërkombëtare,

4.2 Vetëqeverisja Lokale

Qeveria zotohet që e ardhmja e organizimit të pushtetit lokal të jetë e bazuar në Kartën Evropiane mbi Vetëqeverisjen Lokale.

Në këtë kontekst, më poshtë paraqiten objektivat strategjike kryesore:

Rritja e kapacitetit fiskal - komunat të krijojnë kushte për rritjen e shkallës së pavarësisimit buxhetor, duke e zgjeruar gamën e të hyrave vetanake dhe duke e ngritur shkallën e inkasimit.

Korniza afatmesme e zhvillimit të pushtetit lokal dhe Strategjia e zhvillimit komunal, përmes hartimit të strategjive të zhvillimit komunal dhe në të cilat do të përfshihen planet zhvillimore komunale, planet zhvillimore urbane dhe planet rregullative urbane.

Reforma e administratës lokale duhet të optimalizohet, përmes procesit të ngritjes së strukturave të qëndrueshme administrative, kryerjes së disa shërbimeve të përbashkëta për disa komuna nga një shërbim i vetëm apo përmes shfrytëzimit të burimeve të jashtme.

Ngritja e kapaciteteve komunale përmes thithjes dhe koordinimit të ndihmës së donatorëve për të krijuar sisteme elektronike të përdorimit dhe lëvizur administratën lokale drejt qeverisjes.

Legjislacioni dhe pushteti lokal në tërë territorin e Kosovës do të punojë Ligjet që rregullojnë të drejtat në referendum, sistemin zgjedhor lokal, bashkëpunimin dhe zhvillimin regjional e ndërkuftar, organizmin ligjor të qyteteve të mëdha, janë në agjendën legjislative të MAPL-së. MAPL do të mbetet e zotuar të promovojë pushtetin lokal me karakter shumë-etnik dhe reforma e pushtetit lokal do të shtrihet në tërë territorin e Kosovës.

Definimi i kompetencave në shërbimet publike komunale - konsideron esenciale kthimin e kompetencave të tjetërsuara tek autoritetet komunale nga institucionet tjera, posaçërisht në lëmin e shërbimeve komunale.

4.3 Mjedisi dhe Planifikimi Hapësinor

Mbrojtja e mjedisit dhe planifikimi hapësinor që përfshinë ajrin, ujit, tokën etj. ka ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror. Përkundër gjendjes jo të mirë të trashëguar, si në fushën e planifikimit hapësinor, urbanistik, mjedisit jetësor, menaxhimit dhe mbrojtjes së burimeve të ujit, shfrytëzimit të pakontrolluar të pasurive natyrore, zhvillimit të pakontrolluar të kapaciteteve industriale e biznisore, zbatimit të pamjaftueshëm të legjislacionit etj. Qeveria do të përgatis kornizën ligjore, dhe në rrafshin implementues do t'i inkorporojë dhe zbatojë normat ndërkombëtare.

Zbatimi i këtij programi do të sjellë përfitime në cilësinë e planifikimit hapësinor, duke orientuar zhvillimin e infrastrukturës dhe aktivitetet urbane e rurale, mbrojtjen e mjedisit jetësor, ngritjen e institucioneve kompetente, furnizimin e popullatës me ujë të pijshëm si dhe përmirësimin e sistemit të ujërave të zeza dhe trajtimin e mbeturinave.

Qeveria do të inkurajojë zhvillimin e fushatave të ndërgjegjësimit, me qëllim të mbrojtjes së mjedisit. Gjithashtu, do të promovojë shfrytëzimin racional dhe të qëndrueshëm të pasurive natyrore dhe tokës bujqësore, mbrojtjen e peizazheve të vlefshme natyrore si: parqet nacionale, monumentet e natyrës, shpellat, kanionet, ujëvarat, bifurkacionin, liqenet glaciale etj., mbrojtja e llojeve të rralla bimore e shtazore dhe të rrezikuara, e veçanërisht i atyre endemike, ruajtja dhe menaxhimi efikas i zonave të mbrojtura me vlera të larta të biodiversitetit (rezervatet strikte, parqet kombëtare, etj.).

Qeveria do të angazhohet për rehabilitimin e deponive industriale, deponive të materieve të rrezikshme dhe deponive tjera, si dhe rehabilitimin dhe rregullimin e shtretërve të lumenjve dhe liqeneve akumulues. Zgjerimi i sistemit të monitorimit dhe ndërtimi i rrjetit të ri për monitorimin e cilësisë së ajrit dhe veprimeve hidrometeorologjike.

4.4 Bashkëpunimi me donatorët

Ndihma për Kosovën do të jetë një faktor shumë i rëndësishëm në zhvillimin e saj. Qeveria është e përkushtuar që të sigurojë shfrytëzim efektiv të ndihmës, në linjë me parimet për të cilat donatorët tanimë kanë shprehur përkushtimin e tyre.

Qeveria pret me padurim që donatorët të shfrytëzojnë sistemet qeveritare dhe procedurat për transfere dhe implementim, që janë duke u vënë në vend. Kjo do të ndihmojë në ngritjen e kapaciteteve dhe siguron pronësinë e Qeverisë. Veç kësaj, kjo ndihmon në zvogëlimin e kostos së transaksioneve. Implementimi do të duhej të ishte në duart e entitetit përkatës qeveritar, në bashkëpunim të ngushtë me donatorin apo përfaqësuesin e tij.

Qeveria, kërkon gjithashtu, nga donatorët që të shqyrtojnë format tjera të përkrahjes, sikur është përkrahja për sektorët e buxhetit apo përkrahja direkte buxhetore përbrenda sistemeve ekzistuese dhe funksionale të menaxhimit të financave publike dhe llogaridhënies. Vlen të theksohet që një studim i kohëve të fundit, i ndërmarrë nga Qeveria dhe grupet tjera të interesit jashtë saj, tregon që sistemet financiare publike të Kosovës, nuk janë më pak të mira sa u përket masave të llogaridhënies financiare për shpenzimet publike, krahasuar me shumë vende të tjera që pranojnë përkrahje direkte buxhetore. Qeveria do të vazhdojë me ngritjen e kapaciteteve në sistemet e tyre dhe i fton donatorët të kontribuojnë në këto përpjekje.

Që donatorët të jenë në gjendje të sigurojnë përkrahje buxhetore, Qeveria është e përkushtuar të ketë strategji dhe politika të gatshme dhe do të inkurajojë koordinimin aktiv të çështjeve në nivelet sektoriale dhe nivelet makro.

4.5 Barazia Gjinore

Duke u nisur nga përkushtimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për integrimin institucional të perspektivës gjinore, duke u nisur nga përcaktimi për krijimin dhe implementimin e legjislacionit, politikave, mekanizmave dhe masave për avancimin e pozitës së gruas dhe, duke u nisur nga implementimi i tërë këtij procesi në të gjitha fushat e jetës politike dhe shoqërore, duhet të promovohet barazia gjinore, si parakusht për

funkcionimin e institucioneve demokratike dhe si kusht për proceset integruese evropiane dhe tejetlantike.

4.6 Kultura, Rinia dhe Sporti

Mungesa e kujdesit të mjaftueshëm për kulturën ka ndikuar dukshëm në shpërbërjen e komunitetit artistik, i cili është ndër komunitetet më të paorganizuara në Kosovë. Pagat e dobëta (nëse janë të punësuar) i detyrojnë artistët që të mbijetojnë, duke kërkuar punë në profesione tjera ose të braktisin Kosovën në kërkim të një ambienti më të përshtatshëm për karrierë artistike.

Mungesa e investimeve në projekte artistike dhe kulturore ka pasur si pasojë zvogëlimin e interesimit të publikut për konsumimin e vlerave artistike dhe kulturore si dhe mungesën e promovimit të kulturës së Kosovës jashtë vendit.

Gjendja në të cilën është sot kultura shtron nevojën e përkrahjes së projekteve që do të rimëkëmbin jetën teatrore, kinematografike, figurative, muzikore etj. Paralelisht me rritjen e investimeve në vepra arti duhet zhvillimin edhe një fushatë sensibilizimi të opinionit, me qëllim të rikthimit sa më shpejtë të publikut të munguar në teatër, kinema, galeri artesh, salla koncertesh etj.

Prioritet në vete do të jenë investimet në ruajtjen dhe restaurimin e trashëgimisë kulturore. Në këtë vazhdë vlen të stimulohen edhe aktivitete që kultivojnë ruajtjen e traditës, dokeve dhe riteve nacionale, të cilat mund të jenë bazë e vlefshme edhe për zhvillimin e turizmit rural, duke e trajtuar atë edhe si burim biznesi për komunitetin.

Gjendja e tanishme do të adresohet përmes objektivave politike si më poshtë:

Kompletimi dhe plotësimi i Infrastrukturës Ligjore si dhe zbatimi i tij: Zyra ligjore e ministrisë në bashkëpunim dhe koordinim me Zyrën Ligjore të Kryeministrit do të angazhohet në përmbushjen e kornizës ligjore menaxhuese të ministrisë. Në vazhdimësi do ta

plotësojë atë me hartimin e ligjeve në fushën e kulturës, zbatimin e ligjeve të aprovuara, nxjerrjen e akteve nënligjore dhe udhëzimeve për funksionimin efikas, gjithnjë duke i harmonizuar me ligjet vendore dhe parimet e BE-së.

Përkujdesja ndaj trashëgimisë kulturore: Përkujdesja ndaj trashëgimisë kulturore është përgjegjësi kolektive dhe faktor i rëndësishëm në zhvillim të qëndrueshëm shoqëror dhe ekonomik në nivel të vendit, rajon dhe më gjerë. Ministria, së bashku me institucionet përgjegjëse, do të vazhdojnë me punë sistematike në procesin e ruajtjes së tërësive kulturo-historike, zhvillimin e planeve dhe studimeve për rehabilitim, menaxhimin dhe mirëmbajtjen e tyre.

Një vëmendje të veçantë gjatë vitit 2008 do t'i kushtohet programit për digjitalizimin e vlerave të trashëgimisë shpirtërore në bashkëpunim me institucionet relevante vendore dhe ato ndërkombëtare.

Prezantimi i vlerave të trashëgimisë kulturore dhe vetëdijesimi i popullatës do të vazhdojnë edhe gjatë vitit 2008. Implementimi i projektit kapital “Kosova gjatë shekujve” është një nga projektet kryesore për këtë vit, e që implementohet nga Muzeu i Kosovës.

Mbështetja e Institucioneve të Kulturës: Në strukturën organizative të ministrisë veprojnë 30 institucione të kulturës, prej të cilave 9 të nivelit qendror dhe 21 të nivelit komunal. Edhe pse shuma që ndahet për kulturën në raport me buxhetin qendror nga të gjitha vendet e rajonit është shumë e vogël dhe njëkohësisht krijon kufizime shumë serioze. Ministria do të angazhohet për mbështetje të veprimtarisë themelore të tyre si dhe aktiviteteve në sferën e kreacionit, inkurajimit dhe ngritjes së kapaciteteve njerëzore.

Projektet kapitale si: Teatri dhe Opera “Dr. Ibrahim Rugova” dhe Muzeu i Artit Bashkëkohor janë në përfundim e sipër dhe do të prezantohen edhe në Konferencën e Donatorëve, e cila do të organizohet nga Qeveria e Kosovës.

Ndërkombëtarizimi dhe Infrastruktura e Sportit: Departamenti i Sportit në fokusin e vet kryesor ka angazhimet për ndërkombëtarizimin e sportit dhe njëkohësisht për t'iu përshtatur rrethanave të reja në raportet ndërkombëtare si dhe për të siguruar një gamë më të gjerë të

kushteve dhe mundësive për sportistët e Kosovës. Raportet institucionale me Federatat, Klubet, Komitetin Olimpik dhe struktura tjera ky departament i ka kurorëzuar përmes aprovimit të Ligjit për Sport. Procesi i pranimit të federatave kosovare në asociacionet ndërkombëtare pritet të dinamizohet, e që do të rezultojë me implikime financiare.

Finalizimi dhe Implementimi i Politikave dhe Planit Kosovar të Veprimit për Rini:

Struktura e re e popullatës në Kosovë e vendos Departamentin e Rinisë në një pozicion shumë sfidues në raport me kohën dhe nevojat e zhvillimit të politikave multisektoriale, me qëllim të favorizimit të rinisë kosovare. Puna e këtij departamenti në bashkëpunim me OJQ-të vendore dhe ndërkombëtare, tani më pjesë të pandara të këtij departamenti, do të finalizojnë Planin Kosovar të Veprimit për Rini.

Bashkëpunimi në nivelin vendor dhe ndërkombëtar: Zhvillimi i dialogut ndërkulturor në reciprocitet dhe integritet në plane rajonale, evropiane dhe më gjerë, e veçanërisht promovimi i identitetit kulturor kosovar, si një kërkesë imediate, është një nga objektivat e ministrisë gjatë vitit 2008 e tutje.

4.7 Regjistrimi i popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave

Regjistrimi i popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave, është vendosur si prioritet për shkak të rëndësisë jetike që ka për zhvillimin e shumanshëm të Kosovës. Përbushja e këtij prioriteti do të mundëson krijimin e një baze të fortë statistikore, që do të lehtëson dukshëm hartimin e politikave zhvillimore të vendit. Në këtë kontekst, është planifikuar a) organizimi i një konference për donatorë për regjistrimin e përgjithshëm të popullsisë, b) organizimi i punëtorisë trajnuese sipas rekomandimeve ndërkombëtare dhe përgatitja e prokurimeve, c) punësimi i mbikëqyrësve, kontrollorëve, regjistruarëve dhe punëtorëve të tjerë në terren, d) organizimi i aktiviteteve trajnuese për mbikëqyrës, kontrollorë dhe regjistruarë, e) fushata sensibilizuese, prodhimi i fletushkave, letrave, postierëve dhe informacioneve të tjera, f) shtypja e hartave për regjistrimin e përgjithshëm, prodhimi dhe testimi i aplikacionit të TI-së për përfshirjen e të dhënave të Regjistrimit të Përgjithshëm si dhe g) përgatitja e listës së tabelave për analizat e të dhënave të regjistrimit.

4.8 Diaspora

Republika e Kosovës ka një diasporë të fortë dhe numerikisht të madhe. Diaspora, mërgata, kosovarët jashtë vendit nuk janë shfrytëzuar institucionalisht – në formë të organizuar në të mirë të zhvillimit të shtetit të Kosovës. Kosovarët jashtë vendit presin që Qeveria e Kosovës të bëjë për ta atë që nuk është bërë asnjëherë deri me tash. Për një përkujdesje më të mirë dhe të qëndrueshme duhen larguar pengesat e shumta, ato të vogla dhe ata të mëdha. Detyrë primare e Qeverisë në përballje me sfidat drejt largimit të këtyre pengesave është krijimi i autoritetit të qëndrueshëm qeveritar, që do të merret me problemet e diasporës, gjithmonë në mbështetje të ligjit, mundësisht në përafrim me legjislacionin e BE-së.

Veprimet që qeveria e Kosovës do t'i ndërmarrë përfshijnë:

- Hartimi i projektligjit për diasporën dhe harmonizimi i plotë i tij me ligjet tjera të Republikës së Kosovës si dhe, zbatimi i tij,
- Krijimi i ambasadave, konsullatave, shoqatave për mbrojtjen e kosovarëve jashtë vendit,
- Përpjekjet diplomatike të Qeverisë Kosovare për mbrojtjen e kosovarëve jashtë vendit,
- Ngritja dhe bashkimi i komunitetit kosovar jashtë vendit,
- Krijimi i lehtësirave për nxjerrjen e dokumenteve të udhëtimit,
- Ruajtja dhe kultivimi i identitetit kulturor,
- Grumbullimi i të dhënave për Diasporën kosovare (si p.sh. vendndodhja e tyre, lidhjet e tyre me Kosovën, përgatitjet e tyre profesionale, bizneset e tyre),
- E drejta e votës,
- Informimi i kosovarëve jashtë vendit,
- Ngritja e kapaciteteve njerëzore profesionale.